



AMANETI I PAPËRMBUSHUR DHE FJALORI ETIMOLOGJIK I PROF. NORBERT JOKLIT¹

Agron Alibali

1. Hyrje; 2. Në zgrip të humnerës; 3. Përpjekja e Madhe; 4. Skeda biografike e OSS - 1943; 5. Faqe e shndritshme; 6. Një jetë për librat dhe Fjalorin Etimologjik; 7. Testamenti i Prof. Norbert Joklit; 8. Një nismë private dhe e pavarur; 9. Qëndrimi i palës austriake; 10. Biblioteka dhe Fjalori Etimologjik; 11. Qëndrimi i shtetit shqiptar; 12. Fati i Fjalorit Etimologjik; 13. Përfundime. Shtojcë: 1. Kartolina e Joklit për Nolin; 2. Lista e librave dhe materialeve arkivore të Joklit.

¹ Punimi është paraqitur për herë të parë në 27 prill 2018 në Akademinë e Shkencave në Tiranë gjatë prezantimit të botimit shqip të veprës së Joklit *Studime përmbi etimologjinë dhe fjalëformimin e shqipes*, përkthyer nga E. Çabej (lënë dorëshkrim), shtëpia botuese Çabej. Autori shpreh mirënjohjen për Atë Artur Liolinin, Prof. Nikolla Panon, Prof. Anila Omari, Brikena Çabej, Dr. Etleva Domi, Neka Dokon, Benson Tendler, për ndihmën e vlefshme në kryerjen e këtij studimi. Fotoja në ballinë është dhuratë personale e Prof. Norbert Joklit për Prof. Eqrem Çabejn. Originali ndodhej deri vonë në Institutin Çabej në Tiranë.

“Me këtë dijetar albanistika humbet një përfaqësues të madh, atë që e pat zgjedhur studimin e shqipes për mision të jetës së tij. Përtej caqeve të dijes, edhe populli shqiptar humbet një burrë, i cili, duke rrahur me frymë objektive ravën shkencore, u bë njëkohësisht dhe indirekt një mbrojtës i të drejtave tona nacionale.” Eqrem Çabej.

1. Hyrje

Ky studim përqendrohet në jetën dhe veprën e Norbert Joklit [24 shkurt 1877 - 11 maj 1942], gjuhëtarit dhe Albanistit të shquar, viktimë e Holokaustit. Për Joklin është shkruar shumë dhe figura e tij shumëplanëshe do të vijojë të studiohet në të ardhmen. Vetëm me çka njihet deri më sot nga vepra e tij, Jokli mbetet pikë referimi në gjuhësinë shqipe e më gjerë. Studimi shpalos lidhjet simbiotike midis Shqipërisë dhe Joklit, që u kurorëzuan me mbështetjen që Mbretëria Shqiptare dha për Fjalorin Etimologjik, kryepunës së Joklit dhe ofertën për shtetësi shqiptare. Më tej, studimi përcjell hapat e Joklit për të emigruar nga Vjena në Angli, SHBA, dhe në Shqipërinë e pushtuar, si dhe përpjekjet vigane të të gjithë shqiptarëve për shpëtimin e Joklit në orën më të zezë të historisë. Në fund studimi gjurmon fatin e bibliotekës, arkivës dhe Fjalorit të tij Etimologjik dhe analizon shkurt nga ana juridike të drejtat e Shqipërisë apo të “popullit shqiptar” si “trashëgimtar”. Studimi është pjesë e një projekti më të gjerë e më të plotë në gjuhën angleze.

2. Në zgrip të humnerës

Në janar të vitit 1931 një kartolinë urimi do të mbrinte në apartamentin e Fan Nolit në Boston. Dërguesi ishte linguisti i shquar austriko-hebreas, Prof. Norbert Jokl.

Kartolina niste kështu:

Fort i ndershmi Zotni Fan Noli !

urimet më të përzëmërta për Motin e Ri !²

Tash një vit njerëzimi kishte hyrë në dekadën e tretë të shekullit, në fund të së cilës bota papritmas, do të ndodhej në buzë të humnerës.

Norbert Jokli atë kohë ishte profesor i lingustikës krahasuese indoeuropiane dhe kryebibliotekar në Universitetin e Vjenës. Universi i tij studimor në lingustikë ishte i gjerë dhe i thellë, por dashuria e tij e vërtetë ishte shqipja. Me punë e ngulm Jokli ishte bërë, pa fjalë, Albanisti më i shquar i kohës.

² Teksti i tejskruar dhe i plotë i kartolinës jepet në fund.

E pra, dashuria e parë e Joklit kishte qenë drejtësia. Vërtet, ai kishte mbaruar studimet e larta në Fakultetin Juridik të Universitetit të Vjenës dhe ishte diplomuar fillimisht si jurist. Rigoroziteti burimor, detyrimi për saktësi dhe aparati thujse i pagabueshëm metodologjik i analizës juridike me siguri kishin ndërtuar themelin e domosdoshëm për formimin Joklit në fushën e indoeuropianistikës, ku ai do të shkëlqente.

Mirëpo dekada e tretë e shekullit solli përmbysje të paparashikuara, tektonike për fate shtetesh, kombesh e individësh, përfshirë edhe "dijetarin tonë", siç e quan Çabej.³ Ardhja në fuqi e Hitlerit në Gjermani, miratimi i ligjeve anti-semite, aneksimi i Austrisë, tronditën në themel jetën dhe punën e studimit të madh. Jokli nuk ishte Ajnshtajni. Mirëpo Dijetari Ynë ishte pa dyshim një Ajnshtajn në shkencat linguistike.

Në fund të nëntorit 1937 Jokli do të vizitonte për herë të parë - dhe të fundit - Shqipërinë me rastin e kremtimeve për 25 vjetorin e Pavarësisë. Pritja, nderi dhe respekti që iu bë ishin të jashtëzakonshme.




Figura 1 - Lista e delegacionit nga Austria që mori pjesë në kremtimin e 25 vjetorit të Pavarësisë. Emri i Joklit (i gërmëzuar jo saktë) shfaqet në fund.⁴

³ Eqrem Çabej, Në tridhjetëvjetorin e vdekjes së Norbert Joklit, "Mësuesi", 25 tetor 1972, ku autori bën një sintezë të gjallë e të plotë të jetës dhe veprës së mësuesit dhe kolegut të vet.

⁴ Raport i Legatës amerikane në Tiranë drejtuar Sekretarit të Shtetit, 24 nëntor 1937, NARA, Records of the Department of State relating to the Internal Affairs of Albania, 1910-1944; 875.415/18.

Me këtë rast, vetë Mbreti Zog i akordoi Medaljen më të lartë të Mbretërisë, Urdhërin e Skënderbeut, i cili iu dorëzua Joklit në shkurt të vitit 1938 përmes Konsullatës së Mbretërisë Shqiptare në Vjenë.⁵

Gjatë vizitës së Joklit në Shqipëri në nëntor – dhjetor 1937 u diskutua edhe ngritja e Institutit Albanologjik në Tiranë, pararendës i vërtetë Akademisë së Shkencave, ide të cilën Jokli e përkrahu fuqishëm “me prestigjin e emrit të vet.”⁶

Në Tiranë, ku me gjasë qëndroi në sarajet e Emine Toptanit,⁷ Jokli takoi shumë nga miqtë e tij, me të cilët kishte patur korrespondencë të dendur. Njëri prej tyre ishte Aleksandër Xhuvani. Mik i kahershëm, Xhuvani pat ndërhyrë në qeverinë e Shqipërisë së vobegte të vitit 1929 që Joklit t'i akordoheshin 5000 franga ari për botimin e Fjalorit Etimologjik të Gjuhës Shqipe...⁸

Ndër miq të tjerë ishin edhe Petraq Peppo e Lasgush Poradeci. Do të shkruante ky i fundit në maj 1938 për Fjalorin Etimologjik të Joklit, që vazhdonte “*me denjësi veprën kapitale të Meyer-it*”:

*“Në kohën e fundit Jokl-i nuk ka patur tjetër qëllim, tjetër dëshirë më të fundit të jetës së tij, përveçse pritjen e pensionimit [...] për të ardhur pastaj pa humbur asnjëditë në Shqipëri, ku të munda të kontrollojë, në vend, dhe të verë në pikë disa vështirësira gjuhësore të Fjalorit, të plotësuar përfundimisht në pjesën më të madhe të lëndës”.*⁹

Mirëpo ndryshe nga qetësia dhe paqja e Shqipërisë, Vjena në kthim e priti Joklin me krizën e pashembullt politike në Austri. Nuk kaluan as 4 muaj, dhe me 13 mars 1938 Gjermania aneksoi Austrinë.

Pak më vonë, me 20 maj 1938, Jokli u pushua nga puna si hebreas. Ishte më se e qartë se për “Dijetarin tonë” nuk kishte më të ardhme në Ostmark...Ai papritmas u gjend në zgrip të humnerës.

⁵ Dosja e Norbert Joklit në Arkivën e Universitetit të Vjenës, AT-UAW/UB A 58/Zl. 1938-42.

⁶ Lasgush Poradeci, Qeveria e Shqipërisë të shpëtojë Jokl-in nga antisemitizmi nazist, Tiranë, 22 maj 1938, AQSH, Fondi 486, D. 2482, v. 1938, tek Shaban Sinani, Hebrenjtë në Shqipëri, prania dhe shpëtimi, Tiranë, Naimi, 2009, f. 119.

⁷ E veja e Fazil Toptanit, Emine Toptani, grua me kulturë shumë të gjerë dhe kampione e lëvizjes feministe në Shqipëri, ishte një ndër “burimet” gjuhësore të Konicës për fjalë dhe shprehje të shqipes. Shih, A. Alibali “Faik Konica - Dritëhijet e një Diplomati”, Argeta LM, 2016, f. 73. Mendimi se Jokli qëndroi tek banesa e saj mbështetet në të dhëna të tërthorta të Johanna Gerechter Neumann referuar edhe Erika Përmeti Toptanit.

⁸ Mahir Domi, Me rastin e 30 vjetorit të vdekjes, Prof. dr. Norbert Jokl (1877-1942) dhe epistolari i tij, Studime Filologjike, 4/1972. Shkruan më tej prof. Domi: “*Në qershor 1929 Prof. Jokli, pasi ka mbaruar punën e gjatë përgatitore dhe po fillon hartimin e “Fjalorit etimologjik të gjuhës shqipe”, që do të ishte kurorëzimi i gjithë veprimtarisë shkencore të tij, bën të njohur se një vepër të tillë s'del shtëpi botuese që ta marrë përsipër pa një ndihmë financiare të mirë. Duke parë rëndësinë shumë të madhe që kishte kjo vepër e botimi i saj për studimet shqiptare, prof. A. Xhuvani ia del edhe kësaj here që të sigurohet fondi i nevojshëm. **Shuma e dërguar nuk u përdor; duhet të ketë mbetur në bankë a në llogarinë e botuesit.**”.* Po aty. [Theksimi imi, A.A.].

⁹ Poradeci si sipërcituar, po aty.

3. Përpjekja e Madhe

Nisi kështu Përpjekja e Madhe për Shpëtimin e Norbert Joklit.

Destinacioni i parë, krejt i natyrshëm për të, u bë Shqipëria e Mbretit Zog. Xhuvani, Çabej, Poradeci¹⁰, Peppo, për të përmendur vetëm disa, filluan pa humbur kohë përpjekjet brenda administratës mbretërore për strehimin dhe vendosjen përfundimtare të Joklit në Shqipëri. Në maj 1938 Poradeci u propozonte autoriteteve shqiptare që Instituti Albanologjik në Tiranë të udhëhiqej e të drejtohej nga professor Jokli, “*i cili ka për të qenë zemra dhe jeta e tij*”.¹¹

U duk se ardhja dhe ngulja e Joklit në Shqipëri do të ndodhte shpejt. Disa muaj më vonë Aleksandër Xhuvani nga Tirana i shkruante Petraq Peppos në Vjenë:

*"Të gjithë këtu, sa e njohim dhe e çmojmë z. Jokli, jemi gëzue pa masë se muerr rrugë të mbarë puna e tij dhe po e presim me padurim."*¹²

Dhe më tej:

*"Për punë të Joklit kam bisedue gjithënjë me z. Ministër dhe shkresat e tij i kam këndue. **Tash po presim që të fitojë nënshtetësinë t'onë.** Të fala Z. Jokli. Ju shtrëngoj dorën me mall. A Xhuvani"*.¹³

Letra mban datën 6 mars 1939.

Një muaj më vonë Mbretëria Shqiptare do të humbte pavarësinë. 7 prilli 1939 shoi edhe shpresën dhe dëshirën e Joklit për të marrë shtetësinë shqiptare e për t'u ngulur shpejt në Shqipëri.

Menjëherë Jokli i hodhi sytë tjetërkund. Destinacioni i dytë u bë Anglia. Në verën e vitit 1939 Jokli bëri përpjekje të ethshme për të emigruar atje përmes një miku të vet, avokat.¹⁴ Çuditërisht në botën akademike angleze nuk u gjet asnjë gjuhëtar i fushës dhe kalibrit të Joklit, që ta mbështeste apo “sponsorizonte” ardhjen e tij.

¹⁰Vijon më tej Poradeci: “*Këtë qëllim i-a-u shfaqti prerësisht nxënësve dhe miqve të tij shqiptarë në kryeqytet, me rastin e ardhjes për të marrë pjesë në kremtimet e 25-vjetorit të Ngritjes së Flamurit*”. Lasgush Poradeci, po aty, ff. 117-122.

¹¹Po aty. Poradeci vijon: “*Profesor Jokli-i ka për të organizuar, jo një institut me funksionim administrativ, ku anëtarë savant të shkruajnë periodikisht studime mbi çështjet albanologjike, por një organ të gjallë, praktik, që vëzhgon dhe konstaton dhe vleftëson për ças dhe hap pas hapi realitetet dhe fenomenet shqiptare në një Seminar Albanologjike, të cilit t'i mbetet pastaj për trashëgim vazhdimi i veprës së inauguruar prej themeltonjësit dhe mjeshtërit të math, në kohët që kanë për të ardhur dhe nënë trajtën eventuale të një Fakulteti të Letrave Shqipe.*” Faqe 120.

¹² Letërkëmbimi Xhuvani - Peppo, Biblioteka Kombëtare e Vjenës, Autogr. 279/114(1-9)

¹³ Po aty.

¹⁴ Letërkëmbime të Joklit – arkivat britanike. Materiali më i plotë në një studim të proces të autorit në gjuhën angleze.

Për më tepër, shumë shpejt edhe Britania e Madhe u përfshi në luftë me Gjermaninë. Pas 1 shtatorit, 1939 edhe porta britanike u mbyll përfundimisht.

Tash mbetej vetëm Amerika.

4. Skeda biografike e OSS - 1943

Në vjeshtën e vitit 1943, në mes të Luftës II Botërore, një grup studiuesish të Universitetit të Harvardit përgatiti një skedë për Norbert Joklin.

Shtetet e Bashkuara kishin themeluar Zyrën e Shërbimeve Strategjike (OSS), pararendëse e CIA-s, ku ishin ftuar të ndihmonin mendjet më të ndritura të botës akademike amerikane. Pjesë e kësaj përpjekjeje ishte edhe nisma *American Defense, Harvard Group*, e përbërë nga profesorë të atij universiteti të shquar, e ngritur mbi baza kryesisht vullnetare qysh më 1940.

Një ndër qëllimet ishte hartimi i listave të personaliteteve të shquar të shkencës, të rrezikuar nga zezona naziste edhe për shkak të prejardhjes së tyre hebrease. Ndër ta ishte edhe Jokli.

Skeda për Joklin - e shkruar në kohën e tashme gramatikore - ishte përmbledhje biografike e jetës dhe karrierës së tij. Aty përmendej se Jokli ishte një nga ekspertët më të shquar në fushë të gjuhëve indo-gjermane dhe sllave. Skeda theksonte edhe se Jokli ishte "*autor i një fjalori ende të pabotuar në gjuhën shqipe*", si dhe linguist me famë botërore e profesor i filologjisë, deri sa u pushua nga nazistët në mars 1938.

Skeda e OSS mbante datën 5 nëntor 1943. Shtohet aty edhe kjo e dhënë për Joklin: "*Punësimi i tashëm i panjohur; adresa e mundshme Vjena*". Mirëpo, mjerisht, Prof. Jokli kishte humbur jetën mëse një vit më parë. Me sa duket amerikanët ende nuk e kishin mësuar fatin e tij të zi.




Fig. 2 - Skeda e OSS për Prof. Norbert Joklin. Referenca në fund të dokumentit. Ndryshe nga Anglia, Jokli kishte në Shtetet e Bashkuara edhe kolegë të fushës, sikurse Prof. Harold H. Bender në universitetin Princeton dhe Alfred H. Sturtevant në Yale. Mirëpo miqtë e paktë, kolegë linguistë, që e njihnin punën e tij, me sa duket nuk e kuptuan rrezikun që i kanosej Joklit. Moshë "e thyer" përmendej shpesh si faktor jo-favorizues, dhe përpjekjet për punësimin e tij në ndonjë universitet amerikan nuk dhanë fryte. E pra, Jokli në atë kohë nuk ishte më shumë se 62 vjeç...

5. Faqe e shndritshme

Ndër ata që u përkushtuan me shpirt për shpëtimin e Joklit, kryet e vendit e ze Fan S. Noli. Duke huazuar një shprehje nga Prof. Nikolla Pano, "përpjekjet" e Nolit për shpëtimin e Dijetarit Tonë, ishin mirëfilli "heroike".

Dyshja Noli - Konica, pas "ribashkimit historik" të Bostonit me rastin e vizitës së motrave të Zogut në pranverën e vitit 1939 në SHBA, e ktheu nguljen e Joklit në Amerikë, si të thuash, në kauzë të vetën parësore. Konica dhe Noli, të cilët e kishin njohur Joklin në vjenë në mesin e dekadës së parë të shekullit XX, diskutonin shpesh për fatin e mikut të tyre të hershëm e të madh, si dhe për strategjinë që duhej ndjekur për shpëtimin e tij.

"Për Joklin bëra disa çape - sed frustra!" - i shkruante Konica Nolit në vitin 1938.¹⁵ Dy vjet më vonë ishte Fan Noli që, pa dyshim në bashkërendim me Konicën, i pat kërkuar Hito Sadikut në konsullatën italiane në Nju Jork, që të ndërhynte tek autoritete gjermane "për të ndihmuar Profesorin Jokl".

¹⁵ Letër e Konicës për Nolin, Nr. 90, dt. 02.07.1938, N. Jorgaçi, Letërkëmbimi i Fan Nolit, Erik, Tiranë, 2013, f. 330.

Raportet e Nolit e Konicës me Joklin dhe përpjekja e komunitetit shqiptaro-amerikan për të ndihmuar Joklin në ditët e tij më të vështira, dhe për ta shpëtuar përfundimisht atë, përbëjnë pa dyshim ndër faqet më të shndritshme në jetën dhe historinë e bashkësisë shqiptare në Amerikë.

Faqja e parë e shndritshme ishte kontributi thelbësor i Vatrës, i njëmendësuar përmes Konicës, për botimin e një vepre madhore të Joklit. Libri në fjalë ishte *Kërkime gjuhësore-kulturore-historike në fushë të shqipes*.¹⁶ Në krye të tij autori Norbert Jokl përmend tre organizmat që ndihmuan botimin. Krahas Akademisë së shkencave të Austrisë dhe Shoqatës së ndihmës emergjente për shkencën dhe artin austriak dhe gjerman në Nju Jork, aty renditet plot nder e dinjitet edhe VATRA, Federata pan-shqiptare në Amerikë. Botimi i kryeveprës së Joklit është meritë e veçantë e Faik Konicës dhe është një ndër aktet më të vyera të federatës historike.¹⁷

Përpjekjet titanike të Nolit për shpëtimin e Joklit përbëjnë faqen e dytë të shndritshme, por që mjerisht përfundoi në mënyrë tragjike. Disa të dhëna të saj përcillen në njëfarë mase në letrën dramatike të Joklit drejtuar Hirësisë së Tij të datës 31 tetor 1941, të ribotuar [këtu](#).¹⁸

Sipas kërkesave ligjore për emigrim, Noli i kishte dërguar Konsullatës amerikane në Vjenë tri deklaratat mbështetëse - *affidavit* - në favor të Joklit. Mirëpo Konsullata nuk e njoftoi fare Joklin për sa më sipër. Pak më vonë, më 9 korrik 1941, Konsullata amerikane në Vjenë - si e vetmja dritare që lidhte Austrinë e pushtuar me Amerikën, u mbyll.¹⁹ Çështjet e emigrimit në Amerikë i kaluan për kompetencë drejtpërdrejt Departamentit të Shtetit në Uashington.

Sipas dëshmimeve gojore, Noli i shkruajti edhe vetë Presidentit amerikan Roosevelt, por nuk kemi gjetur provë për këtë.²⁰

Për shpëtimin e Joklit Noli u lidh jo vetëm me autoritetet përkatëse amerikane, si dhe me institucionet e specializuara që ndihmonin studiues në rrezik, por u mbështet edhe në komunitetin e gjerë shqiptaro-amerikan. Kësisoj, mund të thuhet se shpëtimi i Joklit nga zezona naziste u kthye në kauzë të përbashkët dhe sipërore të mbarë komunitetit shqiptar të Anglisë së Re.

Sikurse qartëson Jokli në letrën drejtuar Nolit, rregullat e rrepta amerikane të imigrimit të vitit 1941 kërkonin tashmë edhe dy dorëzanë, mirëpo Jokli vetë nuk njihte kend në Amerikë. Me ndërhyrjen sigurisht të Nolit dorëzanët për Joklin u gjendën pa vonesë ndër shqiptaro-amerikanë të shquar. Ata ishin Lili Mihali

¹⁶ Linguistisch - kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen, Berlin und Leipzig, 1923.

¹⁷ A. Alibali "Faik Konica, Dritëhijet e një Diplomati", Argeta LM, Tiranë, 2016, f. 72.

¹⁸ Agim Vinca, Letërkëmbimi i Joklit me Nolin, Peizazhe të Fjalës, 27 prill 2018,

¹⁹ [A Guide to the United States' History of Recognition, Diplomatic, and Consular Relations, by Country, since 1776: Austria \(The Republic of\)](#).

²⁰ Dëshmia për korrespondencën me Rooseveltin është dhënë nga Prof. Nikolla Pano në një bisedë telefonike në prill 2018. Një komunikim Noli - Hitler referohet në shtypin shqiptar në formë telegrami pa datë të saktë, por kopje a gjurmë të origjinalit nuk kemi gjetur.

[Ellias Mitchell], nga lagja Jamaica Plain e Bostonit, dhe Rako Theodhore, nga qyteti Manchester, në shtetin New Hampshire.

Sipas Atë Arthur Liolinit, Lili Mihali ishte një ndër *"aleatët e ngushtë të Nolit, shtëpia e të cilit, në Heath Street, Jamaica Plain [lagje e Bostonit, shënim imi, A.A.], shërbeu si zyra de facto"* e Peshkopit tonë.²¹

Kurse Rako Theodore, edhe ai njëri ndër miqtë besnikë të Nolit, ishte biznesmen i fuqishëm e kontribues i rëndësishëm financiar për Kishën. Sipas Atë Liolinit, Theodore ishte mjaft i ndershëm dhe i besuar [honorable and trustworthy], dhe madje ngjante me aktorët e njohur Gary Cooper dhe Jimmy Stewart.²²

Prof. Nikolla Pano i përshkruan të dy si *"ndër shqiptaro-amerikanët më të kamur të brezit të tyre, antarë aktivë të Vatrës dhe Kishës Ortodokse Shqiptare në Amerikë, si dhe mbështetës të mëdhenj dhe besnikë të Nolit. Ata ishin ndër të parët shqiptaro-amerikanë që ndërtuan lidhje me politikanët amerikanë"*.

Prof. Pano mendon se *"Noli mund të ketë siguruar mbështetjen apo shërbimet e tyre për të kontaktuar politikanët [amerikanë] të njohur të tyre në emër të përpjekjeve për të siguruar vizën për Joklin"*.²³

Sikurse e shkruan vetë Jokli në letrën për Nolin, fatkeqësisht, rrokullima e pamëshirshme e kohës u ndodh gjithnjë një hap para përpjekjeve masive për shpëtimin e tij. Fill pas sulmit japonez të Pearl Harbour-it [7 dhjetor 1941], me 11 dhjetor 1941 Gjermania hitleriane i shpalli luftë Amerikës.

Për Dijetarit tonë tashmë edhe porta amerikane u mbyll plotësisht...

Drita e vetme dhe e zbehtë në fund të tunelit mbetej Shqipëria.

²¹ *"Gruaja e tij - Taska - shtronte drekë e darkë sa herë që Noli kishte vizitorë"*. Sipas Atë Arthurit, Lili Mihali ishte xhaxhai i Esther Athanas, e shoqja e Anthony Athanas Komunikim me Atë Arthur Liolin përmes postës elektronike, prill 2018.

²² Që të dy u nderuan më vonë nga Kisha Ortodokse Shqiptare e Amerikës me titullin Kalorës të Shën Gjergjit, nderi më i lartë që Arqipeshkopata u jep mbështetësve laikë [layman]. Po aty.


²³ Komunikim me Prof. Panon përmes postës elektronike, prill 2018. Sipas prof. Panos, *"që të dy ishin antarë të shquar të komunitetit shqiptaro-amerikan nga viti 1920 e deri në fund të viteve 1950, dhe ishin ndër të parët biznesmenë të suksesshëm të komunitetit...Që të dy e filluan nga tregtia me pakicë e bananeve për të arritur të bëhen pronarë të kompanive rajonale të tregtisë me shumicë të bananeve. Mitchell kishte të drejta ekskluzive të tregtisë për United Fruit Company në rajonin e Bostonit, kurse Theodore i kishte këto të drejta për New Hampshire"*.

5. Përsëri Shqipëria

Një përpjekje e parë për të ndihmuar Joklin ishte ndërmarrë nga Atë Gjergj Fishta në shtator 1939,²⁴ kohë kur Jokli kishte shteruar përpjekjet për në Angli dhe po ngulmonte për t'u vendosur në Amerikë.

Nën ndikimin e hershëm të Nolit, administrata e Shqipërisë së pushtuar kishte marrë vendim me 3 shtator 1941 për t'i ofruar punësim me kontratë Joklit, me pagë 600 franga në muaj deri në qershor 1942. Letra e Koliqit, si Ministër i Arsimit, drejtuar personalisht Joklit, mbante datën 6 tetor 1941.

Edhe pse mjerisht nuk pati efekt, letra ishte e pashembullt edhe sidomos për retroaktivitetin e kontratës, e cila hynte praktikisht në fuqi me 1 korrik 1941, d.m.th tre muaj më herët. Praktikisht, Joklit i garantohej paradhënie prej 1800 frangash, që duhet të ishin të mjaftueshme për shpenzimet e udhëtimit, bartjen e bibliotekës, arkivës dhe të tjera. Në fund Jokli porositej që "*porsa të merrte shkresën, të kryente formalitete e udhëtimit dhe të nisej sa më parë në Tiranë*".



²⁴ Kolec Çefa, Një letër e pabotueme e Fishtës [për Jakomonin, A.A.] në mbrojtje të Joklit, "Illyricum : e përmuajshme shoqërore, informative e Shoqërisë Kulturorë ~ "Illyricum"" , Nr. 3 janar, 2002, f.3. Sipas një burimi tjetër, Fishta ia përcolli Joklit një kopje të letrës për Jakomonin përmes dy etërve françeskanë që e vizituan Joklin në Vjenë në shtator-tetor 1939. Anza Shkodra, Një takim i lanun në harresë, Hylli i Dritës, 2016/2, ff. 235-242.

Fig. 3 - Letra e Ernest Koliqit për Joklin; [Biblioteka Kombëtare e Austrisë, Koliqi, Ernest, Autogr. 279/45].

Mirëpo kishte mbetur shumë pak kohë.

Ndërkaq prof. Çabej në Romë – sikurse u përmend - po përpiquej "të zinte një odë" për të pritur profesorin dhe mikun e tij gjatë rrugës për Shqipëri.²⁵ E megjithatë, Jokli nuk u nis kurrë për Tiranë. Përse vallë?

6. Një jetë për librat dhe Fjalorin Etimologjik

Ndofta arsye, apo arsytet e vërteta s'do t'i mësojmë kurrë. Kronika e atyre ditëve të zeza, të pritjes së një rrezeje drite që nuk erdhi kurrë, duhet të pasqyrohet diku në arkivat diplomatike italiane. Dihet se personalitetet më të larta të diplomacisë fashiste, me kërkesë të Tiranës, u angazhuan për të shpëtuar Joklin.²⁶ Në pamje të parë duket e habitshme që edhe kërkesat e Cianos drejtuar Berlinit ranë në vesh të shurdhët. Sa të sinqerta ishin përpjekjet e Romës për shpëtimin e Joklit, këtë nuk mund ta themi pa shqyrtuar dokumentacionin arkivor. Mirëpo nuk mund të mos sjellim në vëmendje këtu thënien e Çabejt se ai "burrë ...u bë njëkohësisht dhe indirekt një mbrojtës i të drejtave tona nacionale." Jokli, pra, që me veprën e tij shkencore mbronte të drejtat kombëtare të shqiptarëve, mos vallë ishte bërë pengesë e tërthortë, por e pakapërcyeshme ndaj tezave të doktrinës fashiste se Shqipëria "do të mbetej për jetë një Shqipëri romake, një Shqipëri fashiste"?²⁷

Mirëpo përpjekjet e deritanishme për të rënë në gjurmë të këtyre fondeve arkivore, sidomos korrespondencat me Ambasadën Italiane në Berlin, deri më sot

²⁵ Sipas Brikena Çabejt, që u referohet kujtimeve të të jatit, "në Itali kishte një bashkëpunim solidar miqsh e kolegësh për realizimin e këtij synimi: Prof. Tagliavini linguist i shquar që merrej gjithashtu me shqipen, ishte pjesë e rëndësishme e përpjekjeve. Ai duket të ketë qenë edhe pikë referimi për Joklin, sikurse përmendet në korrespondencën Jokl - Çabej. Më vonë, në 1972, kur Prof. Ölberg organizoi në Innsbruck Kolokiumin madhështor kushtuar Joklit, Tagliavini plak tashmë u nis nga Bologna e shkoi mori gjithashtu pjesë në të. Ekziston një foto e bukur e tij me Çabejn në Innsbruck duke biseduar. Kushedi ç'biseda për Joklin do kenë bërë dy miqtë e kolegët pas 30 vjetësh për mikun e humbur...". Dërguar me postë elektronike, shkurt 2021.

²⁶ Shih edhe Ardian Ndreca, Norbert Jokl: Fati i një biblioteke dhe i një njeriu që i përkisnin Shqipërisë, 18 maj 2021, Mapo : gazetë e përditshme politike, ekonomike, aktualiteti, sociale dhe ~kulturore, Nr. 527, 8 mars, 2012, f.10.
tek <https://shkodraloce.wordpress.com/2012/05/18/ardian-ndreca-norbert-jokl-dhe-fati-i-nji-biblioteke-qe-i-perkiste-shqipnise/>

²⁷ Citimi i Eqrem Çabej nga shkrimi "Mbi tridhjetëvjetorin e vdekjes së Norbert Joklit". Gazeta Mësuesi, 25 tetor 1972. Pasazhi i plotë është: "Me këtë dijetar albanistika humbet një përfaqësues të madh, atë që e pat zgjedhur studimin e shqipes për mision të jetës së tij. Përtej caqeve të dijës, edhe populli shqiptar humbet një burrë, i cili, duke rrahur me frymë objektive ravën shkencore, u bë njëkohësisht dhe indirekt një mbrojtës i të drejtave tona nacionale."

kanë qenë të pasuksesshme, ndofta edhe për shkak të faktit se Ambasada u dëmtua rëndë gjatë bombardimeve të luftës, dhe arkiva e saj u shkatërrua.²⁸

Por gjithsesi, pengesa kryesore për largimin e Joklit nga Vjena u bë sidomos biblioteka dhe arkiva e tij e jashtëzakonshme. Jokli nuk kishte familje, as fëmijë. Ai kishte vetëm librat dhe punën e tij, të pasqyruar në botimet e dorëshkrimit e çmuara e të pafund. Kur zjarri bie në shtëpi, gjëja e parë dhe e vetme është shpëtimi i vetes dhe i familjes. Librat dhe dorëshkrimet ishin fëmijët e Joklit. Ai kurrë nuk mund t'i linte ato pas...

Siç do të shtjellohet më tej, Jokli kishte ngritur gjatë viteve një bibliotekë shumë të pasur, e cila madje krahasohej me pasurinë bibliotekare të një instituti të tërë kërkimor-shkencor. Librat e Joklit kishin edhe një veçori tjetër: ishin të mbushura me shënime e ai nuk mund të ndahej as nga shënimet e tij. Çka është jo më pak e rëndësishme, në këtë bibliotekë Jokli kishte edhe lëndën për përfundimin e "kryepunës" së jetës së tij, Fjalorit Etimologjik. E pra, ky shkencëtar i madh nuk mund të shkonte në Shqipëri për t'i dhënë dorën e fundit Fjalorit Etimologjik pa marrë me vete bibliotekën dhe arkivën.

Mjerisht, Victor Christian, Dekani i Fakultetit të Filozofisë të Universitetit të Vjenës dhe Paul Heigl, Drejtori i Bibliotekës Kombëtare të Austrisë ndërhyjnë tek autoritetet naziste që Joklit t'i ndalohej marrja e bibliotekës me vete. Në pritje të vendimit përfundimtar, rreth shkurtit 1942 Joklin e vizitoi miku i tij, Prof. Carlo Tagliavini [1903 - 1982]. Në atmosferën e zymtë dhe gati të pashpresë të asaj kohe të zezë, Jokli do t'i përcilte këtë fjalë Tagliavinit: "... librat dhe arkivën time ia dhuroj **popullit shqiptar**". Me t'u kthyer në Itali, Tagliavini ia kumtoi Çabejit mesazhin e mikut të përbashkët. Shpresa vdes e fundit. Por, mjerisht, dëshira e Joklit për bibliotekën shprehur Tagliavinit u shndërrua në amanet...

Disa javë më vonë, me 4 mars 1942, prof. Jokli u arrestua në apartamentin e tij në Vjenë. Pas *Anschluss*-it, Jokli kishte qenë nën një trysni të jashtëzakonshme dhe kishte pësuar fyerje dhe privacione të papërshtatshme. Megjithatë, ai i kishte përballuar ato me dinjitet, stoicizëm dhe shpresë, me shpresën e largimit për në Amerikë, ose Shqipëri.

Mirëpo ditët e tij të fundit, pas arresimit, duhet të kenë qenë të paimagjinueshme për tmerrin, dhunën, brutalitetin e skajshëm që u detyrua të kalojë Dijetari ynë...

Nga 9000 hebreasit e Vjenës të deportuar në kampin e shfarosjes në Maly Trostenets në Bjellorusi, vetëm 17 mundën të mbijetojnë.²⁹ Të dhënat arkivore konfirmojnë se Jokli u deportua me 6 maj 1942. Si datë zyrtare e vdekjes jepet 11 maji 1942...³⁰

²⁸ Brikena Çabej mendon se Arkivi Tagliavini mund të jetë çelësi i misterit. U përpoqëm ta gjenim djalin e profesorit të madh dhe ta kontaktonim për të mësuar më shumë e drejtpërdrejt nga ai lidhur me Arkivën Tagliavini. Mësuam se i biri, Luigi Ferdinando, fort i shquar në fushën e vet, jetonte në Zvicër. Ndërkohë që po mendonim mënyrën më të përshtatshme të kontaktit, mësuam se, mjerisht, ai kishte ndërruar jetë në korrik 2017.

²⁹ Prof. Laurel Leff, *America's Shameful Betrayal of Europe's Desperate Jewish Academics in the Holocaust*, Haaretz, 22.1.2020, tek www.tinyurl.com/1x49z5ix

³⁰ Shih edhe www.tinyurl.com/5he7qqgq

7. Testamenti i Prof. Norbert Joklit

Norbert Jokli nuk la trashëgimtarë. Sot ai nuk ka as varr. Jokli maspari ishte jurist. Dhe me siguri ai e ka lënë me shkrim dëshirën e tij të fundit. Ende sot nuk e kemi gjetur testamentin e as ndonjë dokument noterial trashëgimie të tij. Me gjasë, kjo provë e drejtpërdrejtë mund të dalë në dritë dikur. Megjithatë, mund të themi me bindje të plotë se Jokli bibliotekën dhe letrat e tij ia la trashëgim “popullit shqiptar”. Po ku e bazojmë këtë konkluzion?

Së pari, vetë faqja zyrtare e Universitetit të Vjenës e pohon këtë. Shkruhet aty:

*"Edhe pse **Jokli ia la trashëgim bibliotekën e tij Shqipërisë**, ajo u konfiskua dhe u "arianizua", veprim ky i mbështetur në atë kohë nga Viktor Christian, Dekan i Shkollës së Filozofisë së Universitetit të Vjenës, dhe nga Paul Heigl, drejtor i përgjithshëm i Bibliotekës Kombëtare të Austrisë. Koleksioni i gjerë iu dorëzua Bibliotekës Kombëtare (të Austrisë, shënim imi, A.A.) si "huazim" në vitin 1942, dhe u posedua pastaj plotësisht në vitin 1946".³¹*

Së dyti, kemi dëshminë e Hito Sadikut, ish sekretar i Konicës dhe ish. zv. Konsull i Shqipërisë në SHBA, në letërkëmbimin me Nolin, të datës 31 janar 1946. Pasazhi relevant është:

"Kur u kthyesha prej Tiranë në Romë, në shtator 1941, Ju shkrojtja shkurtër mbi zotimet që më dhanë për ardhjen e Profesorit Jokl në Shqipëri. Në qoftë se e keni marrë atë letrën, munt të kini kujtuar, më vonë, se munt të kem dashur t'Ju gënjej. E vërteta është se, nga interesimi Juaj, njerëzit që ishin ahera në fuqi, muar vendimin duke emëruar Profesorin Jokl si drejtor biblioteke, me një rrogë të përmuajshme tridhjet napolina, më duket. Passi u bë ky vendim, Profesorit Jokl iu dërgua në Vjenë një pashaportë shqiptare për t'ardhur në Shqipëri. Këtë lajm m'a thanë disa veta, dhe veçanërisht një nxënës dhe dashamirës i Joklit, Eqrem Çabej, i cili ahere më tha se shikonte të zërë një odë në Romë ku Jokli pritej të qëndrojë disa dit si musafir i Çabeut. Passi shkuan disa kohë, duke pritur me kot, e humbëm shpresën për ardhjen e tij.

Këto që po juthem munt t'i vërtetojnë dhe të tjerë, veçanërisht z. Eqrem Çabej, të cilit i zura besë më shumë, dhe që është i gjallë e ndodhet në Tiranë.

*Në kohët e fundit, kam pyetur disa Shqipëtarë të kthyer nga Austria, dhe më tepër nga Vjena, ku kanë qenë të internuar prej Gjermanëve, dhe ata më kanë thënë se nuk dinë gjë mi fatin e Profesorit Jokl. **Kam dëgjuar se Jokli, nja pesë a gjashtë vjet më parë, pat bërë një testament me anën e***

³¹ <http://geschichte.univie.ac.at/en/persons/norbert-jokl-pd-ao-prof>

të cilt bibliotekën e tij të pasur ja fal Shtetit shqiptar, po bibliotekën më pastaj ja konfiskuan Gjermanët".³²

Së treti, kemi dëshminë e Prof. Eqrem Çabejt. Për të njëmendësuar amanetin e Joklit, prof. Çabej, miku, studenti dhe dishepulli i tij, dikur bëri diçka të pashembullt. Në një fletë me format A4, Çabej përcolli në letër dëshminë e Tagliavinit për amanetin e Joklit... Dhe kjo letër befas u shndërrua në amanet të amanetit. Pas vdekjes së Çabejit ky dokument historik i mbeti familjes. Ajo dëshmi ishte thirrje, në mos sfidë, për brezat pasardhës që të bënin diçka:

"...Carlo Tagliavini, Profesor i Gjuhësisë në Universitet të Padovës në Itali, më tha mua të nënshkruarit në verën e atij viti [1942, shënim imi, A.A.], në Romë, se Prof. Jokli, disa muaj para se të zhdukej, i kishte thënë atij në Vjenë, që gjithë pasurinë e tij, e pasurinë shkencore (me dorëshkrime, bibliotekë, etj), me akt zyrtar ja kishte falur popullit shqiptar (gjermanisht dem albanischen Volk). Unë di se në bibliotekën e tij ai ka paur dhe një dorëshkrim të daktilografuar të Baron Nopcas përmbi Kanunin e Lekë Dukagjinit. Ndër dorëshkrimet e Prof. Joklit ka qenë dhe forma e parë e Fjalorit etimologjik të gjuhës shqipe.

Duke u kthyer në verën e 1944 në atdhe, në Vjenë, u takova me Kolë Rrotën. Ky më kumtoi se biblioteka e Prof. Joklit bashkë me dorëshkrimet etj aso kohe gjindej në një dhomë të mbyllur në Bibliotekën Nacionale të Vjenës.

Tiranë 20 mars 1957 Dr. Eqrem Çabej".³³

³² Nasho Jorgaçi, Letërkëmbimi i Fan Nolit, Erik, Tiranë, 2013, Letër e Hito Sadik për Nolin, Nr. 149, Bari, dt. 30.01.1947, f. 264.

³³ Me qëllim nxitjen e institucioneve shtetërore shqiptare që të angazhoheshin për sjelljen e bibliotekës së Joklit në Shqipëri, e bija e Prof. Çabejit ndër morri hapin e parë thelbësor në këtë drejtim. Në 23 prill 2008, me rastin e Ditës Botërore të Librit, Brikena Çabej ia dhuroi me fisnikëri të rrallë amanetin e amanetit Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë. Akti u pasqyrua në faqen zyrtare të BKSH-së si dhe në shtyp: "Ngjalli interes, në kuadrin e "Vitet Çabej", dhurimi nga ana e znj. Brikena Çabej i një deklaratë të dorëshkruar nga Eqrem Çabej sipas së cilës dëshmohej dëshira e albanologut të shquar Norbert Jokli që gjithë pasurinë e tij shkencore (me dorëshkrime, bibliotekë etj.) t'ia falte popullit shqiptar".

<https://www.bksh.al/ngjarje/121/dita-boterore-e-librit-ne-biblioteken-kombetare>"

"Edhe Çabej, një amanet nga Jokli" : [e bija e gjuhëtarit i dorëzon Bibliotekës Kombëtare letrën e albanologut] / Brikena Çabej ; përg. Violeta Murati, Standard : gazetë e përditshme, Nr. 866, 25 prill, 2008, f.17.

Deklaratë

Pas marrës së Prof. Norbert Joklit atij nga
 fillimi i vitit 1944 - radogë e tij i vitit 1944 -
 qe sot nuk është vetëm një zyrtarisht -
 Carlo Tagliavini, Profesor i gjuhëve në
 Universitet të Padovës në Itali, me tita rrua
 të nënshkruarit në vitin e atij viti në
 Romë, se Prof. Jokli, dita rruaj para të të
 shpirtit, i kishte shpirt atij në Vjenë të
 gjithë punëve e tij e punëve shkencore
 (me dorëshkrimet, bibliotekë etj.) me akt
 zyrtar ja kishte falur popullit shqiptar
 (që mundet dem albanischen Volk). Me
 të se në bibliotekën e tij ai ka punuar
 dhe një dorëshkrim të daktilografuar
 të Baroni Kopera përmbi Kanunin e Lekës
 Dukatimit. Ndër dorëshkrimet e Prof. Joklit
 ka qenë dhe formula e parë e Fjalorit etim-
 logjik të gjuhës shqipe.
 Në ditë u kthyer në në vitin e 1944-5
 në atdhe, në Vjenë u takova me Kolë Rotten-
 berg, me kumtorin e bibliotekës e Prof. Joklit
 bashkë me dorëshkrimet etj. aso Kolë
 Rindaj, me një dhuratë të rebyllur në
 Bibliotekën Nacionale të Vjenës.

Dr. Fiqem Çabej

Tirantë 20. mars 1957

Fig. 4 - Deklarata personale e Çabejt e 20 marsit 1957 [fotokopje referuar bujarisht nga Brikena Çabej].

Dhe së fundi, kemi dëshminë parësore të autoriteteve zyrtare gjermane.

Një shkresë e 3 qershorit 1942 nga *Sicherheitsdienst Berlin* [Shërbimi i Sigurimit i SS] përmban këtë pasazh:

"Shefi i Policisë së Sigurimit dhe i SD në Berlin më ka njoftuar me shkrimin e mëposhtëm të 3 qershorit të këtij viti Nr. III C ---referenca) si më poshtë:

*"Albanologu hebreas Prof. Dr. Norbert Jokl Vjenë zotëron një bibliotekë të rrallë shkencore së cilës i përkasin ndër të tjera Fjalori Shqip me përpunime të hollësishme në dorëshkrim për një botim të ri të mëvonshëm, si dhe një katalog. **Si trashëgimtar për këtë bibliotekë të plotë, e cila për shkencën gjermane ka një vlerë të lartë, Prof. Jokli ka caktuar shtetin shqiptar**".³⁴*

³⁴ Letër për Reichministrinë për Shkencën, Arsimin dhe Kulturën, mbërritur me 4 qershor 1942, [origjinal në gjermanisht], shkruar nga Rudolf Kummer dhe Otto von Rottenburg, Dokumentationsarchiv des Oesterreichischen Widerstandes, Wien, Austria, Original Signature 4219.

Pra, kemi mendimin se dëshira e Joklit për t'ia lënë trashëgim Shqipërisë, apo popullit shqiptar tërë pasurinë e tij bibliotekare dhe intelektuale është e vërtetuar juridikisht katërcipërisht, dhe pa asnjë grimë dyshimi.

8. Një nismë private dhe e pavarur

Në mars 2017 tre shtetas amerikanë, me prejardhje hebrease dhe nga Shqipëria, ndërmorrën nismën për gjurmimin dhe kthimin në Shqipëri të trashëgimisë së Dijetarit tonë.

Letra ishte në trajtën e një kërkesë drejtuar Komitetit Amerikan të Trashëgimisë Kulturore me Jashtë. Ajo bazohej në Marrëveshjen Kulturore SHBA - Shqipëri, të vitit 2004. Mbështetur në të, letra parashtroi tre gjëra:

(i) Biblioteka dhe Arkiva e Joklit të përcaktohen si **pasuri me vlera të posaçme për trashëgiminë kulturore**, dhe të renditen (listohen) si të tilla;

(ii) Komitetit të SHBA për Ruajtjen e Trashëgimisë së Amerikës Jashtë i kërkohet ndihmë për përmbushjen e dëshirës së fundit të Prof. Joklit dhe për transferimin pa vonesë të Bibliotekës dhe Arkivës së tij nga Biblioteka Kombëtare e Austrisë tek Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë;

(iii) Palës shqiptare i kërkohet ndërmarrja e hapave të posaçme që, pasi të transferohen në Shqipëri Biblioteka dhe Arkiva e Joklit, ato të mbrohen dhe ruhen më së miri.³⁵

Letra, që mban firmën e Johanna Gerechter Neumann, Van Sotir Christo dhe të nënshkruarit, është e datës 7 mars 2017.³⁶

Me Johannën kishim bërë biseda të panumërta për Norbert Joklin, për të cilin ajo kishte dëgjuar nga shoqja e vet shqiptare, Erika Përmeti Toptani. Kishim rrahur shpesh edhe idenë e kthimit të bibliotekës së Joklit në Shqipëri. Ajo e kuptonte më mirë se kushdo rëndësinë e aktit të përmbushjes së amanetit të një viktime të Holokaustit. Nisma jonë ishte pikërisht rezultat i ayre bisedave, shkëmbimeve e diskutimeve.

³⁵ Letër e datës 7 mars 2017 drejtuar Komitetit Amerikan për Ruajtjen e Trashëgimisë së Amerikës Jashtë, e nënshkruar nga Johanna Gerechter Neumann, Van Sotir Christo, dhe i nënshkruari.

³⁶ Johanna [Jutta ose Flutura në shqip] Gerechter Neumann dhe prindërit e saj ishin shpëtuar nga Holokausti pikërisht në Shqipëri, ku mbërritën në shkurt 1939 dhe u larguan shëndoshë e mirë në shtator 1945. Sapo mbërritën në Itali familja Gerechter mësoi për here të pare se ç'u kishte ngjarë hebreasve në Europë, dhe qysh nga ai moment nderimi dhe mirënjohja ndaj shqiptarëve u kthye në misionin e tyre. Një përshkrim i shkurtër i tyre jepet [këtu](#).



Fig. 5 - Jutta ose Flutura e Shqipërisë. Foto në Tiranë, gusht 1944, dhuruar Bedri Ramës, fqinjtit dhe mikut të saj shqiptar. [Mirënjohje Petrit Zorbës].

Mirëpo me 26 prill 2017 Johanna Neumann do të ndërronte jetë. Kësisoj, përpjekja për kthimin në Shqipëri të trashëgimisë së Joklit u bë papritur misioni i saj i fundit në këtë botë. Më 21 janar 2020 u nda nga jeta edhe Van Sotir Christo, Konsull nderi i Shqipërisë në Boston. Me ikjen e Johannës barrën e nënës mori përsipër i biri, Benjamin³⁷. Tashmë amanetit të Joklit, si dhe deklaratës së Çabejt, i është bashkëngjitur edhe misioni i fundit i Johannës dhe Vanit. Ose katër amanete të bashkuara në një:

- (i) Amaneti i Joklit;
- (ii) Amaneti i Çabejt;
- (iii) Amaneti i Johanna Gerechter Neumann;
- (iv) Projekti i fundit i Van Christos.

³⁷ Me Benjamin Neumann ndërtuam një bashkëpunim të bukur për të njëmendësuar amanetin e së ëmës. Sëbashku kemi ndërmarrë takime e kontakte të shumta me administratën amerikane, përfshirë Zyrën e Holokaustit në Departamentin amerikan të Shtetit. Përpjekjet tona përkuan, për fat të keq, me krizën e jashtëzakonshme që kalonte BKSH në vitin 2017-2018. Duke mbajtur parasysh problemet e mëdha të hapësirave ruajtëse, dhe në vijim edhe të ideve të hedhura nga publicisti Ben Andoni për kthimin e ish-Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës [QNK] në aneksin albanologjik të BKSH-së, me 4 maj 2018 iu drejtua me letër Kryetarit të Bordit të Fondacionit Amerikano-Shqiptar të Zhvillimit [AADF] për të mbështetur idenë e shndërrimit të QNK-së në Ndërtesën “Norbert Jokl” të BKSH-së, si aneks i veçantë, ku të strehoheshin dhe ruheshin në jetë të jetëve trashëgimia e Joklit, por edhe e albanologëve të tjerë të shquar, vendas e të huaj. Vërejtëm ndërkohë që QNK-ja i ishte hequr nga pronësia Ministrisë së Kulturës dhe i ishte transferuar Bashkisë së Tiranës, një vendim që, për mendimin tonë, ishte i pamenduar dhe i gabuar. [QNK ishte ndërtuar me punën, gjakun e djersën e gjithë shqiptarëve, dhe jo vetëm të banorëve të Tiranës...]. Ende sot nuk ka përgjigje nga AADF.

9. Qëndrimi i palës austriake

Por cili është qëndrimi i palës austriake ndaj trashëgimisë së Joklit?

Droja e parë ishte se qëndrimi zyrtar austriak do të qe mohues, rezistues. E vërteta doli se ishte ndryshe.

Prirja e përgjithshme në të drejtën ndërkombëtare gjatë periudhës së pasluftës e deri vonë ka evoluar drejt njohjes së krimit të përbindshëm, dënimit të fajtorëve, zbutjes së pasojave ndaj viktimave e trashëgimtarëve të tyre, kompensimit ekonomik e financiar, kthimit të pasurive të grabitura etj. Në thelb të trajtesës sonë lidhur me Joklin si një ndër viktimat e Holokaustit janë Parimet e Konferencës së Washingtonit [1998] dhe Deklarata e Terezinit [2009].

Në përputhje me sa më sipër, qeveria austriake ka ndërmarrë hapa konkrete, pohuese dhe të prekshme për kthimin tek trashëgimtarët e viktimave të të gjitha pasurive të hebreasve austriakë, të grabitura gjatë Holokaustit.

Ligji Federal për Kthimin e Veprave të Artit dhe Pasurive të Tjera Kulturore nga Muzeumet dhe Koleksionet Federale Austriake dhe nga Pronat e Tjera Federale,³⁸ parashikon parimet, rregullat, procedurat dhe fondet për kthimin tek trashëgimtarët e viktimave të pasurive të grabitura.

Në raportin e vitit 2004 të Komisionit përkatës qeveritar gjendet i shpallur botërisht edhe vendimi për kthimin e tërë trashëgimisë së Joklit "tek trashëgimtarët e tij".³⁹ Pra, qysh në vitin 2004 qeveria austriake ka njohur dhe ka vendosur kthimin "tek trashëgimtarët" të pasurisë bibliotekare dhe akademike të Joklit.

10. Biblioteka dhe Fjalori Etimologjik i Norbert Joklit

Duhet thënë se trashëgimia bibliotekare e Joklit përbëhej nga rreth 3000 libra tejet të çmuar e të rrallë, që përbënin Bibliotekën e tij, dhe dhjetra dorëshkrime, mijëra letërkëmbime etj.

Një shkresë zyrtare e autoriteve gjermane e 10 shtatorit 1942, pra fare afër kohës së sekuestrimit të saj, na jep gjendjen më të saktë të Bibliotekës së Joklit. Shkruhet në dokument:

"Biblioteka e Joklit përfshin afërsisht 3000 blenjë (vëllime). Meqenëse ai ishte indoeuropianist dhe gjuhëtar krahasues, ai pati mbledhur në mënyrë shumë sistematike literaturën e specializuar që i nevojitej për punimet e tij shkencore. Kështu, biblioteka përmban revista, fjalorë, libra gjuhësie (gjuhe), doracakë, libra reference dhe traktate gjuhësore të çdo lloji.

³⁸ I referuar si BGBI. Nr. 181/1998.

³⁹ Restitution Report 2003/2004, Sixth Report of the Federal Minister of Education, Science and Culture to the NATIONALRAT (Lower Chamber of the Austrian Parliament).

Megjithëse Jokli si albanolog është marrë kryesisht me studimin e gjuhës shqipe dhe ka mbledhur me kujdes literaturën dhe monumente gjuhësore të shqipes, ai ka grumbulluar pothuajse në të njëjtën mënyrë edhe literaturën e nevojshme për një studim të të gjitha gjuhëve të Europës Juglindore.

Prandaj, biblioteka e tij përbën një bibliotekë veçanërisht specifike e cila i nevojitet vetëm studiuesit të gjuhësisë së krahasuar, i cili ka zgjedhur si fushë studimi një hapësirë ku takohen gjuhët gjermanike, sllave, romane, ugro-fine dhe të tjera. Kjo bibliotekë tepër e specializuar duket e plotësuar me vepra të përgjithshme mbi antikitetin, historinë, filozofinë dhe kulturën e vendeve dhe të popujve të hapësirës së përmendur. Përveç kësaj ka edhe separate të shumta nga revista që trajtojnë probleme të gjuhës, dhe prandaj janë shumë të vlefshme sepse në shumicën e tyre vijnë nga revista shumë të rralla (që mezi gjenden). Veprat e veçanta dhe botimet e plota të klasikëve gjermanë dhe autorëve të njohur në gjuhë të ndryshme, që përbëjnë rreth 1/5 e bibliotekës, duhen parë si pjesë e genësishme e bibliotekës shkencore.⁴⁰

Pas arrestimit të Joklit, biblioteka e tij, kjo pasuri e jashtëzakonshme, u konfiskua me 27 prill 1942, nga Zyra e Vjenës e *Reichssicherheitshauptamt*, një nga divizionet e frikshme të SS që merej me rendin dhe "problemet racore". [Zyra e Sigurisë Qendrore të Rajhut]. Porsi hienat, menjëherë bibliotekën e Joklit u vërsulën për ta marrë në dorëzim Biblioteka Kombëtare e Austrisë dhe Fakulteti i Filozofisë i Universitetit të Vjenës, aty ku Jokli kishte studiuar, dhënë mësim, dhe ku kishte qenë kryebibliotekar për vite me rradhë...

Betejën e palavdishme e fitoi Biblioteka Kombëtare e Austrisë. Në 20 maj 1943 librat u bënë zyrtarisht pjesë e inventarit të saj. Sipas dokumentit zyrtar të sotëm të shtetit austriak "për shkak se [pas vitit 1945] askush nuk e pretendoi, biblioteka nuk iu kthye asnjëherë trashëgimtarëve."⁴¹

⁴⁰ Letër për Reichministrinë për Shkencën, Arsimin dhe Kulturën; Nationalbibliothek Zani: 1439/1654. Nënshkrimi i autorit/dërguesit i palexueshëm.

⁴¹ Restitution Report 2003/2004, Sixth Report of the Federal Minister of Education, Science and Culture to the NATIONALRAT (Lower Chamber of the Austrian Parliament). Versioni në anglisht i tij përmbledh si më poshtë:

*Dr. Norbert Jokl was deported to Minsk in 1942 and murdered in Maly Trostinec on 11 May 1942. Jokl's library was confiscated by the Vienna Office of the Reichssicherheitshauptamt [Central Security Office of the Reich]. The National Library and the Vienna Faculty of Philosophy each laid claims to the inventory. Since 26 June 1942 the library was kept by the National Library. On 20 May 1943 the books were officially integrated into its inventory. **For lack of a claimant the library was never restituted after 1945. Nullity of transfer of ownership as defined by the Restitution Act is evidenced by the provenance note "P[olice] 1938". Restitution of the prints was recommended according to Section 1 subpara 2 Restitution Act on 27 April 2004.*** [Theksimi imi, A.A.].

Sikurse u përmend më lart, kthimi përfundimtar i Bibliotekës së Joklit tek trashëgimtarët u vendos me **27 prill 2004**, pra rreth 17 vjet më parë, në përputhje me Nenin 1, nënparagrafin 2 të Ligjit austriak për Kthimin.⁴²

Mirëpo vetëm një fraksion i trashëgimisë së Joklit është identifikuar si e tillë gjatë "autopsisë", apo kontrollit të përgjithshëm të inventareve të ndërmarre në Bibliotekën Kombëtare të Austrisë, në fillim të viteve 2000.

Lista e pasurisë intelektuale të Joklit, e përcaktuar për "t'iu kthyer trashëgimtarëve" nga qeveria austriake përbëhet sot nga vetëm 169 libra, 10 njësi bibliotekare fotografike, 1 dosje dokumentesh (Autographs), 5 njësi bibliotekare dorëshkrimesh. Kaq. Po pjesa tjetër?⁴³

11. Qëndrimi i shtetit shqiptar

Shteti shqiptar në vijimësi ka shfaqur mbështetje të plotë e të pakursyer për veprën e Joklit:

- Sikurse u përmend, shteti shqiptar miratoi dhe livroi fondin prej 5000 frangash ari qysh në vitin 1929 për botimin e Fjalorit Etimologjik të Joklit;
- Mbreti Zog i akordoi Joklit dekoratën më të lartë shtetërore në nëntor 1937;
- Para pushtimit italian Mbretëria Shqiptare i ofroi shtetësinë Prof. Joklit;
- Autoritetet shqiptare nën pushtim e ftuan Prof. Joklin në vitin 1941 duke e emëruar në postin e posaçëm si "organizatuer" i bibliotekave të Shqipërisë;
- Pas Luftës II Botërore Jokli i njoh përgjithësisht si një ndër etërit e studimeve të gjuhës shqipe dhe referohej vijimësisht dhe rregullisht nga studiuesit në Shqipëri, Kosovë etj;
- Në vitin 1960 Prof. Petraq Peppo hartoi një studim të hollësisëhm për autoritetet shtetërore ku përmbledhi bibliotekat, arkivat dhe dorëshkrimet e studiuesve të huaj, të cilat duhet t'i ktheheshin Shqipërisë. Ndër to përmendeshin edhe Biblioteka dhe Arkiva e Prof. Joklit, të cilat "i takonin popullit shqiptar"⁴⁴.
- Në 1972, me rastin e 30 vjetorit të vdekjes tragjike të Joklit, në Innsbruck të Austrisë, në bashkëpunim me Universitetin e atij qyteti, Akademia e Shkencave e Shqipërisë organizoi një Konferencë Shkencore ndërkombëtare të jashtëzakonshme për jetën dhe veprën e Joklit. (Nismëtar i të cilit ishte Prof. Hermann Ölberg i Universitetit të Innsbruckut, në bashkëpunim me Prof. E. Çabej. (letërkëmbimi Ölberg-Çabej).
- Në 1977 profesorët A. Kostallari dhe E. Çabej hartuan listën e plotë të dorëshkrimeve të Joklit në Bibliotekën Kombëtare të Austrisë;⁴⁵

⁴² Shih shënimin 33 më lart.

⁴³ Lista e jepet në Shtojcën në fund të punimit.

⁴⁴ Petraq Peppo, Promemorie mi Bibliotekat - Dorëshkrimet - Arkivat, kontribut për të shtuar Visarin e Kulturës Kombëtare, Tiranë, 1960, ff. 5-11, 25-30, koleksion privat.

⁴⁵ Lista ndodhet në Bibliotekën e Institutit të Historisë dhe Gjuhësisë në Tiranë.

- Më 1991 Josef Jakoel, personalitet hebreas-shqiptar, do të përfundonte në daktiloshkrim veprën e tij “Izraelitët e Shqipërisë”, ku përshkruhej edhe kalvari tragjik i Joklit;
- Në 2012 autoritetet postare shqiptare emetuan një seri të posaçme filatelike për nder të Norbert Joklit.

Ky qëndrim i shtetit shqiptar nuk mund të mos konvertohet sot në hapa konkrete drejtuar autoriteteve austriake për identifikimin e plotë e shterues të trashëgimisë së Joklit në Austri dhe kthimin pa vonesë e tërësor të saj [përfshirë efektet financiare] në Shqipëri sipas vetë amanetit të tij dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe ligjet e Austrisë dhe Shqipërisë.

12. Fati i Fjalorit Etimologjik

Dihet botërisht se Fjalori Etimologjik ishte "kryepuna" e Joklit. Ai konsiderohej deri vonë si i humbur.

Dëshmi të rëndësishme për Fjalorin Etimologjik na jep Prof. Mahir Domi. Mbështetur në “bisedën ditunore” apo korrespondencën Jokl - Xhuvani, Domi shpjegon se personi që i rekomandoi Joklit qysh më 1924 të hartonte Fjalorin Etimologjik ishte Wilhelm Streitbergu [1864 - 1925], “redaktori i përmbledhjes “Histori e gjuhësisë indo-evropiane” botuar në Strasburg më 1917, ku Jokli shkroi një histori të gjuhësisë shqipe”. Punën përgatitore [“ai e kishte mbledhur lëndën, kishte formuar idetë”] Jokli e përfundoi në qershor 1929 dhe i hyri punës për “hartimin definitiv të fjalorit”, ose “veprës madhore që do të ishte sinteza, përgjithësimi, kurorëzimi i gjithë veprimtarisë së tij shkencore”.

Sipas Poradecit, në nëntor 1937 Jokli ishte në fazën përmbyllëse të “kryepunës” së tij dhe priste t’i jepte dorën e fundit në Shqipëri.⁴⁶

Për Fjalorin Etimologjik të Joklit, sikurse përmendëm në krye, kishin dijeni edhe autoritetet amerikane qysh në vitin 1943.

Në vitin 1950 një ish diplomat amerikan në Vjenë do të shkruante:

“Norbert Jokl, i padiskutueshëm në epërsinë e tij të studimeve shqiptare, prej kohe po merrej me fjalorin etimologjik të shqipes, i menduar si magnum opus i tij. Është aq e trishtë të mendosh se Jokli jo vetëm që humbi jetën si viktimë e brutalitetit të Gestapos, por edhe sepse dorëshkrimi i tij, që do të kishte rritur më tej reputacionin e tij të lartë, nuk i mbijetoi atij”...⁴⁷

⁴⁶ Me nguljen e Joklit në Shqipërinë e Mbretit Zog, ai do të mund “të kontrollojë, në vend, dhe të verë në pikë disa vështirësira gjuhësore të Fjalorit, të plotësuar përfundimisht në pjesën më të madhe të lëndës”. Poradeci, shih më lart në tekst, dhe sipas burimit të sipërcituar.

⁴⁷ An Historical Albanian English Dictionary, by Stuart E. Mann, Gordon M. Messing, Language, Vol. 26, No. 3 (Jul. - Sep., 1950), pp. 320-422.

Norbert Jokl, whose pre-eminence in Albanian studies was uncontested before the war, had long been preparing an etymological dictionary of Albanian intended as his magnum opus. It is saddening to reflect, not only that Jokl lost his life as a victim of Gestapo brutality, but also that his manuscript, which would certainly have done credit to his high reputation, has not survived him.

GORDON M. MESSING, *American Legation, Vienna*

Figura 6 - Imazh i pasazhit të Messing për fjalorin etimologjik.

Gjendjen më të saktë e më të fundit të Fjalorit na e jep rishtas Shkresa e 10 shtatorit 1942. Shkruhet aty:

"Jokli planifikonte botimin e një Fjalori Etimologjik të Gjuhës Shqipe si përmbyllje e punimeve të tij më të rëndësishme shkencore. Prandaj ai donte të përpunonte materialin voluminoz që gjatë viteve e kishte hedhur në shënime në vetë librat dhe në fletë ose pusulla (Zetteln = skeda) të ndryshme.

Fjalori nga njëra anë do të përmbante një katalog (tablo) kritike të literaturës gjuhësore albanologjike dhe nga ana tjetër, çështjet specifike të historisë së gjuhës, të historisë dhe të kulturës së vetë hapësirës shqiptare. Shënimet gjenden në një ekzemplar të lidhur apo të qepur të Fjalorit shqip të Godinit, në margjinat e librave të ndryshëm të shtypur, dhe në fletëza letre të shumta, në pjesën më të madhe me stenografinë e Gabelsbergerit, dhe për këtë arsye, janë të shfrytëzueshme në një masë shumë të kufizuar nga ata që zotërojnë⁴⁸ plotësisht stenografinë e Gabelsbergerit.⁴⁹

Në mbyllje të skicës së tij të famshme me rastin e 30 vjetorit të humbjes së Dijetarit tonë, të botuar në gazetën "Mësuesi", Çabej shkruan:

*"Mjerisht, ..., puna e këtij dijetari të shquar mbeti e pakryer. Sidomos nuk u krye dot vepra që do të kishte qenë kurorëzimi i punës së jetës së tij. Fjalori etimologjik i shqipes dhe gramatika krahasimtare e kësaj gjuhe...Disa dorëshkrime të tij gjinden në bibliotekën Nacionale të Vjenës, ndër to **mbase edhe dorëshkrimi i Fjalorit etimologjik, ose ndonjë pjesë e tij a e skedave përkatëse**"⁵⁰*

Kurse Domi shkruante kështu në 1972:

"N. Jokli nuk ia doli ta kryejë atë, por, ç'ka është më keq, nuk është gjendur gjer më sot as çka ai ka pasë arritur të realizojë. E kjo s'duhet të ketë qenë e pakë, gjersa ai më 1929 kërkon ndihmë për botimin e saj dhe i hyn hartimit përfundimtar. Është e nevojshme të ndërmerren kërkime sistematike për gjetjen e kësaj vepre kapitale që, e dalë nga penda e një specialisti si N. Jokli, është e një rëndësie të veçantë për albanistikën."⁵¹

⁴⁸ Në original është një shënim i paqartë "jo" me shkrim dore.

⁴⁹ Letër për Reichministrinë për Shkencën, Arsimin dhe Kulturën; Nationalbibliothek Zani: 1439/1654. Nënshkrimi i autorit/dërguesit i pallexueshëm.

⁵⁰ Eqrem Çabej, Gazeta Mësuesi, 25 tetor 1972.

⁵¹ Mahir Domi, Me rastin e 30 vjetorit të vdekjes, Prof. dr. Norbert Jokl (1877-1942) dhe epistolari i tij, Studime Filologjike, 4/1972. Nuk përbën synimin e këtij studimi përmendja shteruese e të gjithë studiuesve të përqendruar në ditët e fundit të Joklit dhe fatin e

Albanologu Michael Schmidt-Nekke ka ndërmarrë një studim të qëlluar për Joklin në vitin 2004, që përkoi me ekspozitën *Libra të vjedhura* në Bibliotekën Kombëtare të Austrisë. “*Pas shkrirjes së Departamentit të Europës Juglindore, koleksioni prej 3000 librash [i Bibliotekës së Joklit, A.A.] u shpërnda*”, shkruan ai. Dhe më tej: “*Meqë Jokli nuk kishte trashëgimtarë, nuk pati përpjekje intensive për të identifikuar pasurinë e tij. Kërkime të mëvonshme (si ato të ndërmarra nga Robert Schwanke) kanë mundur të nxjerrin në dritë 170 vëllime, 10 foto portret, dhe dorëshkrimet studimore të Joklit, të cilat u botuan pjesërisht më vonë.*”

Dhe në fund: “*Nuk ekzistojnë gjurmë të fjalorit etimologjik që e kishte në plan Jokli*”.⁵²

Pas një pune këmbëngulëse, dhe me pak fat, më në fund ramë në gjurmë të Skedarit të famshëm të Fjalorit Etimologjik të Joklit. Të dhënat konkrete për ekzistencën e tij të ofruara nga fillimisht nga Çabej, u konfirmuan nga studiuesi i dorës së parë, i mirënjohuri Bejtulla Destani, gjatë një bisede në nëntor 2017 në Tiranë.⁵³

Skedari i Fjalorit Etimologjik të Joklit ndahet në tre pjesë. Pjesa I e Skedarit përmban 169 skeda; Pjesa II ka 196 skeda, kurse Pjesa III ka 206 skeda. Gjithsejt Skedari i Fjalorit Etimologjik të Shqipërisë, i Norbert Joklit, përmban 571 skeda.

Fjalorit të tij Etimologjik. Gjithsesi do të theksonim këtu punën prof. Elton Prifti nga Universiteti i Mannhajmit dhe tash Universiteti i Vjenës, në kumtesën “Carlo Tagliavini vs. Viktor Christian dhe përndjekja e Norbert Joklit në dritën e dokumenteve arkivore të pabotuara”, mbajtur në Tubimin e 5-të kulturor shkencor gjermano-shqiptar “Gjuha dhe kultura e shqiptarëve. Dimensione kohore dhe hapësinore”, Buçimas 5-7 qershor 2014, si dhe punën e studiuesit Albert Ramaj në Svicër.

⁵² Michael Schmidt-Neke, “Norbert - Jokl, Nderohet viktima e Nacional-Socializmit”, in *Albanische Hefte*, 34. 1 (2005): ff. 24-25.

⁵³ Identifikimi i parë i kësaj pasurie të paçmuar u krye me 15 janar 2018, dhe menjëherë u bë porosia përkatëse e dy njësive bibliotekare *Cod. Ser. n. 11907 Han* dhe *Cod. Ser. n. 11780 Han*. Me 26 janar 2018 u miratua riprodhimi tërësor digjital dhe u dorëzua porosia. Riprodhimi u vonua ca, pasi “materiali ishte mjaft i gjerë”. Me 13 prill 2018 vjen më në fund njoftimi për përfundimin e procesit, shoqëruar me faturën përkatëse. Më në fund, me 23 prill 2018 vjen njoftimi përfundimtar për mundësinë e shkarkimit të Skedarit të Fjalorit Etimologjik në trajtë digjitale.

Etymologische Deutungen
 im Kreise der Albanischen
 I.

Figura 7 - Pjesa I e Skedarit.

14
 apoj. P. j. d.
 apoj. α ποβου, διαυδισι
 apuem j. apum, P. apuem P.
 P. vagebure & αα κρησι, αα η
 apu albejare Baik. = p. α. η.
 apulim aurora, alba
 apuem P. u - Koro-k.
 apor p. ααα, aspect
 ap-u occur, buio

Fig. 8 - Skeda 14.





Figura 9 - Fillimi i Pjesës II dhe III të Skedarit.

Pa vonesë, me 27 prill 2018 një kopje e Fjalorit Etimologjik i dhurua Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, ku besojmë se Jokli do ta kishte përfunduar kryepunën e tij nëse do t'i mbijetonte Holokaustit.⁵⁴ Me 30 prill 2018 Skedari i dhurua Bibliotekës Kombëtare të Kosovës dhe disa institucioneve e gjuhëtarëve të shquar atje.⁵⁵

Një tjetër thesar, pjesë integrale e Fjalorit Etimologjik, është edhe ekzemplari i Fjalorit shqip - gjermanisht të Marie Amelie Godinit,⁵⁶ për të cilin Jokli kishte dhënë kontribut parësor [“hartuar me ndihmën teme”, sipas Domit]. Këtë Fjalor të rëndësishëm Jokli e kishte mbushur anekënd me shënimet e veta. Për fat ky

⁵⁴ <https://www.bksh.al/details/122837> Kopje iu dhuruan edhe Arkivës së Insitutit Çabej, Bibliotekës së Akademisë së Shkencave, Bibliotekës së Qendrës së Studimeve Albanologjike, Bibliotekës së Fakultetit të Histori - Filologjisë të Universitetit të Tiranës.

⁵⁵ Po ashtu, edhe Bibliotekës së Fakultetit Filologjik të Universitetit të Prishtinës dhe Bibliotekës së Institutit Albanologjik në Prishtinë.

https://biblioteka-ks.org/Ngjarje/AA_promo.php

⁵⁶ Wörterbuch der albanischen und deutschen Sprache. Bd 1, Godin, Marie Amelie Freiin v. [VerfasserIn], Leipzig : Harrassowitz ; 1930.

libër sot është i ruajtur, dhe ndodhet në listën e librave të bibliotekës së Joklit që pret t'u kthehet “trashëgimtarëve”.⁵⁷

Për arsye të kuptueshme, studimi i mëtejshëm i “kryepunës” së Joklit paraqet vështirësi të jashtëzakonshme e të panumërta edhe për specialistët e mirëfilltë të fushës, ku spikat shkrimi i saj në sistemin Gabelsberger - Noë. U takon gjuhëtarëve tanë të shquar, shumica të dalë nga shkolla e Çabejt, në Shqipëri, Kosovë apo në katedra të shquara nëpër botë, që ta marrin tashmë në dorë stafetën për ndriçimin e plotë të trashëgimisë së jashtëzakonshme të Joklit.

⁵⁷ Bleu me vleftë të paçmuar renditet i dyti në listë, pas Fjalorit të Kristoforidhit, dhe bart këto të dhëna si njësi bibliotekare: Nr: 685812; Autori: Godin, Marie Amelie von: Titulli: Wörterbuch der albanischen und deutschen Sprache Leipzig 1930 l. Restitution Report 2003/2004, f. 41. Shih edhe Shtoj

13. Përfundime

Humbja tragjike e Norbert Joklit është një ndër krimet e përbindshme të nazizmit. Në mes të viteve 1950, Prokuroria Federale Gjermane hapi çështjen penale për vrasjen e dhunshme të prof. Joklit, ndërkohë që pasuria e tij bibliotekare dhe intelektuale ende sot nuk i janë kthyer trashëgimtarit të ligjshëm të saj, “popullit shqiptar”.

90		6. MAJ 1942	MINSK	
388	Jeckel Blima Sara	6.L.Wienzeile	4/9	12.2.96
387	Jeckel Samuel Israel	"	"	17.1.89
415	Jelinek Hermann Israel	2.Gr.Mohrengasse	32/3	28-1.76
417	Jelinek Margarethe Sara	"	"	18.9.17
416	Jelinek Pauline	"	"	26.5.83
862	Jellinek Elisabeth Sara	2.Frz.Hochedlingerg.	23/6	29.12.84
82	<u>Jokl Dr.Norbert Israel</u>	7.Neustiftgasse	57/48	25.2.77
826	Kaempf Alice Sara	2.Frz.Hochedlingerg.	25/18	30.6.94
241	Kafka Karl Israel	7.Neustiftgasse	133/12	11.1.69
733	Kaiser Malwine Sara	9.Gr.Torgasse	12/11	20.10.80
956	Kammermann Mina Sara	2.Förstergasse	5/13	13.1.99
922	Karn Etti Fradel Sara	2.Krafftgasse	4/2	29.1.84

Figura 10 - Pjesë e regjistrit të të deportuarve hebreas-austriakë të nisura nga Vjena me 6 maj 1942 për në kampin e shfarosjes pranë Minskut. Emri i Norbert Joklit, adresa dhe datëlindja, janë shënuar në numrin rendor 82. Burimi: tinyurl.com/ypoj9ebn

Përjekjet për shpëtimin e jetës së Joklit ishin më shumë se gjest fisnik e humanitar ndaj një studiuesi të shquar e miku të ngushtë e të kahershëm të shqiptarëve. Ato mbështeteshin në thelb tek *ndorja*, apo instituti i lashtë i së drejtës dokësore shqiptare që garantonte jetën dhe sigurinë e personit në rrezik. Risija këtu ishte se ndorja bashkonte përpjekjet e miqve të Joklit në dy kontinente e katër shtete, dhe se ai institut i çmuar, madje, ngrihej përmbi rrafshin e *jus non scriptum* (së drejtës së pashkruar). Ndorja tashmë përcillej njëkohësisht si institut i së drejtës dokësore dhe si akt i së drejtës pozitive shqiptare.

E drejta ndërkombëtare nuk parashikon parashkrim për krimet e Holokaustit, por efektet e tyre në lidhje me Joklin në njëfarë mënyre vijnë edhe sot. Biblioteka dhe Fjalori Etimologjik, tij, që në njëfarë kuptimi, u bënë shkas për humbjen e jetës së Joklit të madh, si dhe e tërë pasuria e tij intelektuale, sëbashku me paketën financiare të parashikuar nga ligji austriak, duhet kthyer pikërisht aty ku ajo jetë e dëshironte: në gjirin e popullit shqiptar. Vetëm kështu ato libra e dorëshkrime do të rijetësohen mirëfilli, edhe përmes fondeve e bursave të mundshme për veprimtari studimore e botuese në brezat e ardhshme, duke nderuar përjetësisht kujtimin paharruar të prof. Norbert Joklit.

Me 29 maj 2019 një grup nga Shqipëria, Amerika dhe Franca i dërguan letër qeverisë shqiptare me lutjen që t'i "kërkonte zyrtarisht palës austriake identifikimin e plotë dhe transferimin pa humbur kohë në Shqipëri të të gjithë trashëgimisë së Norbert Joklit, në përputhje të plotë me amanetin e tij".⁵⁸

Apatia e deritanishme e administratës shqiptare post-totalitare për përmbushjen e amanetit të Joklit është e pashpjegueshme.⁵⁹ Këtu duhet të sjellim në vëmendje se burimet e sipërcituara përcaktojnë si trashëgimtarë të Joklit herë "shtetin shqiptar" [shkresa zyrtare gjermane, Hito Sadik], herë "Shqipërinë" [faqja zyrtare e Universitetit të Vjenës], dhe herë "**popullin shqiptar**" [*dem albanischen Volk* – Çabej]. Nëse i qëndrojmë pikëpamjes së Çabejt se Jokli ia pat lënë tërë pasurinë e tij trashëgim "popullit shqiptar", dhe jo një entiteti të përkufizuar shtetëror apo privat, a mos vallë ky përcaktim i përgjithshëm nënkuptonte njëfarë mosbesimi të Joklit ndaj institucioneve të asokohshme të vendit?⁶⁰

Edhe pse në dukje e çuditshme, lind më se arsyeshëm pyetja se cili do të ishte përkufizimi i "popullit shqiptar" apo i "shtetit shqiptar" në kohën kur Jokli i pat kumtuar Tagliavinit amanetin e tij? Dihet se "populli shqiptar" apo edhe "shteti shqiptar" në atë kohë përfshinte edhe viset e Kosovës e Maqedonisë Perëndimore. Kësisoj, mund të argumentohet se "trashëgimtarë" të pasurisë intelektuale të Joklit të mbetur ende në Austri, janë edhe institucionet e "popullit shqiptar" në Republikën e Kosovës.

Çka na kthen tek çinteresimi i Tiranës zyrtare ndaj trashëgimisë së Joklit. Nëse institucionet përkatëse të Tiranës, për çfarëdo shkak apo arsyeje, nuk paraqesin zyrtarisht tek pala austriake pretendimin si trashëgimtarë të pasurisë intelektuale të Joklit, në fund të fundit pse të mos ta ndërmarrin këtë hap Biblioteka Kombëtare e Kosovës, Akademia e Shkencave e Kosovës, Instituti Albanologjik në Prishtinë, apo ndonjë institucion tjetër i denjë e serioz i Republikës së Kosovës?

Dëshira e fundit e Joklit mbetet ende e papërmbushur sot e gjithë ditën. Përprjekjet vijnë. Le të shpresojmë se trashëgimia e Joklit do të mund t'i kthehet "popullit shqiptar" në 80 vjetorin e humbjes së Dijetarit tonë të Madh.

⁵⁸ Ndër nënshkruesit e saj janë Ismail Kadare, Anna Kohen, Petrit Zorba, Van Christo, Nikolla Pano, Benjamin Neumann, Xhevat Lloshi, Seit Mansaku, Pëllumb Khufi, Beqir Meta, Luan Malltezi, Hamit Kaba, Anila Omari, Enkelejda Kopia, Enver Hysa, Richard Lukaj, Cafo Boga, Albana Asllani, Brikena Çabej, etj.

⁵⁹ Me miq amerikanë me të cilët diskutoj këtë çështje shpesh ngrihet pyetja: "Ç'do të kishte ndodhur vallë nëse Jokli do t'ia kish lënë trashëgim veprën e tij një vendi si Sh.B.A. apo një shteti si Izraeli...? A do të kishin qëndruar këta apatikë e indiferentë për 17 vjet me rradhë edhe pasi pala austriake të kishte miratuar "kthimin tek trashëgimtarët"?

⁶⁰ Ky mosbesim i mundshëm i Joklit nuk do të ishte fort larg realitetit konkret në Shqipërinë e vitit 1940, ku mbizotëronte në masë gjerë pakënaqësia dhe rezistenca pasive ndaj Italisë e administratës vendase, si dhe kujtimi për pavarësinë e mohuar dhe nderimi për Mbretin Zog [*"Pictures of King Zog were retained and exposed clandestinely"*]. Raport për Sekretarin e Shtetit i Ambasadës amerikane në Romë, datë 29 mars 1940 me përshtypjet e vizitës në Shqipëri të Dr. Lewis Wendell Hackett [1884 - 1962], i Rockefeller Foundation. NARA, Records of the Department of State relating to the Internal Affairs of Albania, 1910-1944; 875.00/528 dhe 875.00/529

SHTOJCË

1. Kartolina e Prof. Norbert Jokl për Fan S. Nolin e vitit 1930.

Prof. Jokl's Card to Fan S. Noli

Front of envelope	
Unintelligible: Prof. Dr. Norbert Jokl Wien, VII/3 Neustifgasse 67 (Austria)	
Right Reverent Bishop Fan S. Noli Trinity Building, 168 Dartmouth Street Room 318	
	<u>Boston, Mass</u>
Mail Stamp	<u>U.S.A.</u>
Date Stamp	<u>America</u>

Fort i ndershmi Zotni Fan Noli !

Urimet më të përzëmërta për Motin e Ri ! Po përdorë rasjen për me Ju falun nderit për dërgimin (?) e Republikës, të cilën këndoj gjithmonë me një interes të veçantë;

Ç'ban përkthimi i Faustit ? Shpesh edhe me një zell gjithmonë të shtuem këndoj "Rubairat" e Zotnisë së Juej. Përkthimi edhe hyrja janë kryepuna!

Ky përkthim ndez kuqeshitën teme për "Faustin". Do t'ishte një monumentum aere perennius. A e dini që në Biographischen Archiv 4 (në Berlin) ka dalë një jetëshkrim i shkurtë i Zotnisë së Juej?

Tue ju përshëndetun fort e fort

*Glückliches
Neujahr*

Mbetem

*i Jueji
me nder*

*V. Norbert Jokl
Vjenë 30/XII 30*

[Mirënjohje ndaj Bibliotekës Noliene në Boston, MA, Sh.B.A.]

2. Lista e pasurisë intelektuale të Prof. Norbert Jokl e identifikuar deri më sot dhe e miratuar zyrtarisht nga qeveria austriake për kthim “tek trashëgimtarët”. Në shtyllën e djathtë, Shënime, jepen të dhëna identifikuese për librat. Lista përfshin vetëm një pjesë të kësaj pasurie, që lipset të gjurmohet e të plotësohet shumë më tepër.

[Burimi: Biblioteka Kombëtare e Austrisë; Lista përputhet me Restitution Report 2003/2004, Sixth Report of the Federal Minister of Education, Science and Culture to the NATIONALRAT (Lower Chamber of the Austrian Parliament)].

A. Druckschriften

Signatur	Format	Provenienz/Inventar	Autor/Titel	Impressum	Anzahl Bde.	Standort	Provenienz Buch	Anmerkungen
685808	B	P 38	Chustofreides, Konstantinos: Lexikon tes Albanikes glosses	Athen 1904	1	O.S.	k. E.	Dr. Norbert Jokl (Ti.)
685812	C	P 38	Godin, Marie Amelie von: Wörterbuch der albanischen und deutschen Sprache	Leipzig 1930	1		P 38 (St.)	Exemplar mit eingeschossenen Blättern mit Anmerkungen und Korrekturen Norbert Jokls
685816	B	P 38	Jeannarakis, Antonios: Neugriechische Grammatik nebst Lehrbuch der neugriechischen Volkssprache	Hannover 1877	1		P 38 (St.)	Dr. Norbert Jokl (Ti.)
685820	B	P 38	Koiransky, Z.: Neues Deutsch-Russisch und Russisch- Deutsches Taschenwörterbuch	Leipzig 1900	1		P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
685822	A	P 38	Legrand, Émile: Nouveau Dictionnaire Grec moderne - Français	Paris 1882	1	O.S.	k. E.	Dr. Norbert Jokl (Ti.)
685824	A	P 38	Leotti, Angelo: L'Albanese parlato	Milano 1916	1		k. E.	Widmung an Prof. Norbert Jokl 30.10.1930
685825	B	P 38	Leskien, A.: Handbuch der Altbulgarischen Sprache	Weimar 1898	1		P 38 (St.)	Dr. Norbert Jokl (Ti.)

685827	B	P 38	Meyer, Gustav: Etymologisches Wörterbuch der albanischen Sprache	Straßburg 1891	1	P 38 (St.)	Stammt aus der Bibliothek Norbert Jokls. (Einband und handschriftl. Anweisungen Jokls an den Buchbinder)
685836	C	P 38	Sandfeld, Kristian: Balkanfilologien	Kopenhagen 1926	1	P 38 (St.)	Widmung an Jokl
685840	A	P 38	Tases, Koco: Fjalor greqisht-shqip	Athen 1928	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
685841	B	P 38	Thussib, Albert: Handbuch der neugriechischen Volkssprache	Straßburg 1895	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
685843	B	P 38	Vondrák, Wenzel: Altkirchenslawische Grammatik	Berlin 1900	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
685846	B	P 38	Papahagi, Pericle: Parallele Ausdrücke und Redensarten im Rumänischen, Albanischen, Neugriechischen und Bulgarischen	Leipzig 1908	1	P 38 (St.)	Stammt aus der Bibliothek Norbert Jokls. (Einband und handschriftl. Anweisungen Jokls an den Buchbinder)

685847	B	P 38	Papazapheirooulos, Panagiotes: Perisynagoge glossikes hyles kai ethymon tu helleniku lau idia de tu tes poloponnesu paras allomenon en pollois pros ta ton archaie on hellenon	Patros 1887	1		P 38 (St.)	Jokl
685849	B	P 38	Pio, Jean: Contes populaires grecs	Copenhague 1879	1		P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
685853	B	P 38	Rhousopoulos, Rhousos: Wörterbuch der neugriechischen und deutschen Sprache	Athen 1900	1		P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
685854	C	P 38	Rossi, Francesco: Vocabolario della lingua epirotica- italiana	Roma 1875	1	O.S.	P 38 (St.)	Dr. Norbert Jokl, Wien (Ti.)
686056	B	P 38	Diculescu, Constantin C.: Dacia Romană in vglinda inscripiilor si a limbci de azi	Cluj 1926	1		P 38 (St.)	Prof. N. Jokl (Ti.)

686067	B	P 38	Stefanescu, Margareta C.: Elementele ruseștirutene diu limba rominească și vechimea lor	Jasi 1925	1	P 38 (St.)	Prof. N. Jokl (Ti.)
686069	B	P 38	Puscariu, Sextil u. Herzog, Eugen: Lehrbuch der rumänischen Sprache Teil 1	Czernowitz 1920	1	P 38 (St.)	Prof. N. Jokl (Ti.)
686070	B	P 38	Rosetti, Alexandru: Lettres Roumaines de la fin du XVIe et du début du XVIIe siècle	Bucuresti 1926	1	P 38 (St.)	Widmung an Dr. Jokl, Paris 1927
686539	B	P 38	Ancey, Gabriel: Mémoire sur l'Albanais dans le Mythe grec	Paris 1914	1	P 38 (St.)	Widmung an Prof. Norbert Jokl
686544	C	P 38	Chatzes, Antonio: Thothen to ethoikon Skipetar	Athen 1929	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
686545	B	P 38	Chetta-Schiró, Francesco: I Castriota, Principi d'Albania nell'Ordine sovrano e militare di Malta	Valletta 1929	1	P 38 (St.)	Widmung an Jokl, Wien 1932

686553	B	P 38	Friedrich, Johannes: Aus dem hethitischen Schrifttum	Leipzig 1925	1		P 38 (St.)	Stammt aus der Bibliothek Norbert Jokls. (Einband und handschriftl. Anweisungen Jokls an den Buchbinder)
686557	B	P 38	Godin, Maria Amelie von: Aus dem neuen Albanien	Wien 1914	1		P 38 (St.)	Stammt aus der Bibliothek Norbert Jokls. (Einband und handschriftl. Anweisungen Jokls an den Buchbinder)
686559	B	P 38	Hatzidakis, G.N.: Einleitung in die Neugriechische Grammatik	Leipzig 1892	1	O.S.	k. E.	Dr. Norbert Jokl (Ti.)
686561	C	P 38	Hrozný, Bedrich: Über die Völker und Sprachen des Alten Chatti-Landes	Kirchhain o. J.	1		P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
686570	B	P 38	Lambertz, Max: Das albanische Schulwesen vor dem Kriege und Heute	o. O. o. J.	1		P 38 (St.)	Herrn Privatdozenten Dr. Norbert Jokl, v. Vf. 25. VIII. 1918
686571	B	P 38	Lambertz, Max: Die hypothetische Periode im Albanischen	Straßburg 1914	1		P 38 (St.)	Herrn Bibliothekar Dozent Dr. Norbert Jokl

686576	B	P 38	Louis, Herbert: Albanien. Eine Landeskunde vornehmlich auf Grund eigener Reisen	Stuttgart 1927	1	P 38 (St.)	Widmung an Herrn Baron Nopcsa vom Verfasser
686586	B	P 38	Muža, M. Emil: Praktische Grammatik der Serbisch- Kroatischen Sprache	Wien o. J.	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
686587	B	P 38	Nachtigall, Rajko: Die Frage einer einheitlichen albanischen Schriftsprache	Graz 1917	1	P 38 (St.)	Widmung des Autors an Jokl, Okt. 1917
686589	B	P 38	Nopcsa, Franz: Die Albaner	Wien 1913	1	P 38 (St.)	Stammt aus der Bibliothek Norbert Jokls. (Einband und handschriftl. Anweisungen Jokls an den Buchbinder)
686590	B	P 38	Nopcsa, Franz: Az Albániáról szóló legujabb irodalom	Budapest 1918	1	P 38 (St.)	Stammt aus der Bibliothek Norbert Jokls. (Einband und handschriftl. Anweisungen Jokls an den Buchbinder)
686591	C	P 38	Nopcsa, Franz: Sind die heutigen Albaner die Nachkommen der alten Illyrer?	Berlin 1911	1	P 38 (St.)	Brief an Jokl eingehftet

686597	C	P 38	Petrotta, Gaetano: A proposito di un Catechismo Albanese	Roma o. J.	1	P 38 (St.) u. (Bl.)	Jokl (Ti.)
686599	C	P 38	Rosetti, Alexandre: Recherches sur la phonétique du Romain au XVIe siècle	Paris 1926	1	P 38 (St.)	Jokl (Bl.)
686608	B	P 38	Vámbéry, Hermann: Etymologisches Wörterbuch der Turko-Tatarischen Sprachen	Leipzig 1878	1	P 38 (St.)	Stammt aus der Bibliothek Norbert Jokls. (Einband und handschriftl. Anweisungen Jokls an den Buchbinder)
686609	B	P 38	Vasmer, Max: Studien zur albanischen Wortforschung	Doegat 1921	1	P 38 (St.)	Widmung an Prof. Jokl
686614	B	P 38	Weigand, Gustav: Der gegische Dialekt von Borgo Erizzo bei Zara in Dalmatien	Leipzig 1911	1	P 38 (St.)	Widmung an Prof. Jokl, 1911
686616	B	P 38	Whitney, William Dwight: Indische Grammatik	Leipzig 1879	1	P 38 (St.)	Dr. Norbert Jokl (Ti.)
686665	C	P 38	Hrozný, Friedrich: Die Sprache der Hethiter	Leipzig 1917	1	P 38 (St.)	Jokl (Bl.)
686719	C	P 38	Baldacci, Antonio: Le fonti della flora Albanese	Bologna 1925	1	P 38 (St.)	Jokl (Bl.)

687034	A	P 38	Beöthy, Zsoll: A magyar irodalom kistürke	Budapest 1896	1	P 38 (St.)	Exlib. Dr. N. Jokl
687036	B	P 38	Capidan, Theodor: Romanii nomazi	Cluj 1926	1	P 38 (St.)	Jokl 1926 (Ti.)
687044	B	P 38	Sams-al-din, Sami: Shkronjetore e guhese ship	Bucuresht 1886	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
687050	B	P 38	Holtzmann, Adolph: Grammatishes aus dem Mahabharata	Leipzig 1884	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
687052	B	P 38	Hunfalvy, Paul: Ethnographie von Ungarn	Budapest 1887	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
687079	B	P 38	Noli, Fan S.: Historia e Skenderbeut	Boston 1921	1	P 38 (St.)	Dr. Norbert Jokl (Ti.)
687080	C	P 38	Nopcsa, Franz: Geographie und Geologie Nordalbaniens	Budapest 1929	1	P 38 (St.)	Jokl
687092	B	P 38	Bogdan-Duica, George: Vasile Alecsandri	Bucuresti 1926	1	P 38 (St.)	Dr. Norbert Jokl, 1932 (Ti.)
687107	B	P 38	Biblia (alb.): Dhiata e re e Zotit edhe Shpetimtarit t'ene Jisu Krisht	Manastir 1910	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)

687109	B	P 38	Biblia (alb.): Fialet e urta te Solomonit ede Biblia e Isaise te urta Isaise kethgere pas ebraistese bietere skip ude gluche toskeriste	Konstantinopel 1884	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
687119	B	P 38	Biblia (alb.): Dhiata e re e zotit edhe selbuesit t'une Jesu-Kristit	Konstantinopel 1872	1	P 38 (st.)	Jokl (Ti.)
687121	A	P 38	Dodnai, Vissor: Mialt e mblétese	Bukurest 1898	1	P 38 (St.)	Jokl (Bl.)
687125	B	P 38	Faurrés, Rogatien: Skender beu	Sofia 1912	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
687130	B	P 38	Fishta, Gjergj: Anzat e parnasit	Shkoder 1928	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
687152	B	P 38	Koligi, Ernest: Hija e maleve	Zara 1929	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
687167	B	P 38	Mjedja, Ndré: Shêjti shë Luigj Gonzaga	Shkoder 1926	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
687170	B	P 38	Mosi, Hil: Lotët e dashtniës	Shkodrë 1915	1	P 38 (St.)	Widmung an N. Jokl
687171	B	P 38	Mosi, Hil: Zân'i Atdhent	Trieshte 1913	1	P 38 (St.)	Widmung an N. Jokl
687179	A	P 38	Papahristo, S.: Boiskautizma	Tiranë 1927	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
687181	B	P 38	Papahristo, S.: Qeverimi i fëmijvet në shkollë	Tiranë 1928	1	k. E.	Widmung des Autors an Norbert Jokl

687193	B	P 38	Shakespeare, William: Tragjedia e Othello's arapit te Venetikut	Boston 1916	1	P 38 (St.)	Widmung an Prof. Jokl, 1916
687194	B	P 38	Sheper, Ilia Dilo: Gramatika dhe sindaksa e gjuhes shqipe sidomos e toskenishtes	Vlorë 1927	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
687207	B	P 38	Xhuvani, Aleksander: I.H. Pestalozzi	Elbasan 1927	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
687358	B	P 38	Roth, Carl: Geschichte der Christlichen Balkanstaaten	Leipzig 1907	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
687391	B	P 38	Creangă, Jon: Opere complete	Cernauti 1924	1	k. E.	Widmung an Norbert Jokl
687394	A	P 38	Pop, Ghiță: Taschenwörterbuch der rumänischen und deutschen Sprache Teil 1	Berlin- Schöneberg 1911	1	k. E.	Jokl (Ti.)
687628	B	P 38	Argondizza, Francesco: Canti popolari raccolti in Albania (= Biblioteca Italo-Albanese Bd. 2)	Roma 1927	1	Bd. 2: P 38 (St.)	Jokl (Ti.)

687628	B	P 38	Argondizza, Francesco: La lingua degli Die (= Biblioteca Italo-Albanese Bd. 4)	Roma 1933	1		Bd. 4: P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
687695	B	P 38	Jensen, Kr. Sandfeld: Rumaenske Studier 1	Kobenhavn 1900	1		P 38 (St.)	Widmung an Jokl
687963	C	P 38	Rossi da Montalto Ligure, Francesco: Vocabolario Italiano-Epirotico	Roma 1866	1		P 38 (St.)	gesuchtes Buch wurde von Jokl in Universitätsbuchhandlung Gerold & Co. erworben, Rechnung im Buch eingelegt
688103	B	P 38	Ariosto, Lodovico: Ludovico Ariostos Rasender Roland Teil 1	Stuttgart o. J.	1		Bd. 1: P 38 (St.) Zusatz "Bd. 1-4"	Bd. 1: Norbert Jokl Cand. Jur.
688103	B	P 38	Ariosto, Lodovico: Ludovico Ariostos Rasender Roland Teil 2	Stuttgart o. J.	1		Bd. 2: k. E.	höchstwahrscheinlich VB Jokl
688103	B	P 38	Ariosto, Lodovico: Ludovico Ariostos Rasender Roland Teil 3	Stuttgart o. J.	1		Bd. 3: k. E.	höchstwahrscheinlich VB Jokl
688103	B	P 38	Ariosto, Lodovico: Ludovico Ariostos Rasender Roland Teil 4	Stuttgart o. J.	1		Bd. 4: k. E.	höchstwahrscheinlich VB Jokl
688325	A	P 38	Tegnér, Esaias: Frithjof-Sage	Berlin 1854	1		P 38 (St.)	Norbert Jokl (Ti.)

688377	B	P 38	Zola, Emile: La terre	Paris 1898	1		P 38 (St.)	Norbert Jokl, Cand. Iur.(Ti.)
688444	B	P 38	Camões, Luiz de: Die Lusiaden	Stuttgart o. J.	1		P 38 (St.)	Norbert Jokl iur. (Ti.)
727813	C	P 38	Georgescu-Tistu, N.: Bibliografia literară Română	Bucuresti 1932	1		P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
727853	B	P 38	Skendo, Lumo (Frashëri, Midhat Be): Diturija Nr. 1-12, 1909, Nr. 1-3, 1916	Selanik 1909/1916	1		Bd. 1: k. E.	Widmung an Prof. Dr. Norbert Jokl (Ti.)
727853	B	P 38	Skendo, Lumo (Frashëri, Midhat Be): Diturija Nr. 1-2, 1926, Nr. 3-12, 1927	Selanik 1926/1927	1		Bd. 2: k. E.	Widmung an Prof. Dr. Norbert Jokl (Ti.)
727853	B	P 38	Skendo, Lumo (Frashëri, Midhat Be): Diturija Nr. 1-2, 1927, Nr. 3-12, 1928	Selanik 1927/1928	1		Bd. 3: k. E.	Widmung an Prof. Dr. Norbert Jokl (Ti.)
727853	B	P 38	Skendo, Lumo (Frashëri, Midhat Be): Diturija Nr. 1-3 1929	Selanik 1929	1		Bd. 4: P 38 (Bl.)	Widmung an Prof. Dr. Norbert Jokl (Ti.)
727854	C	P 38	Putra, Sh. (Red.): Kultura Islame Nr. 1-12	Tirane 1939	1	O.S.	1939 (Nr.1-12=10 Hefte): P 38 (Bl.)	Zeitschriften adressiert an Dr. Norbert Jokl

727854	C	P 38	Putra, Sh. (Red.): Kultura Islame Nr. 13-16	Tirane 1940	1	O.S.	1940 (Nr. 13-16 = 3 Hefte): Geheime Staatspolizei (Prüfstempel);	Zeitschriften adressiert an Dr. Norbert Jokl
727854	C	P 38	Putra, Sh. (Red.): Kultura Islame Nr. 17-24	Tirane 1941	1	O.S.	1941 (Nr. 17-24 = 4 Hefte): Oberkommando der Wehrmacht (Prüfstempel)	Zeitschriften adressiert an Dr. Norbert Jokl
727857	C	P 38	Normalisti Jg. 3 1931 Nr. 1-4	Elbasan 1931	1		Bd. 3: k. E.	Zeitschriften adressiert an Dr. Norbert Jokl
727857	C	P 38	Normalisti Jg. 4 1932 Nr. 1-6	Elbasan 1932	1		Bd. 4: k. E.	Zeitschriften adressiert an Dr. Norbert Jokl
727857	C	P 38	Normalisti Jg. 5 1933 Nr. 1-4	Elbasan 1933	1		Bd. 5: k. E.	Zeitschriften adressiert an Dr. Norbert Jokl
727857	C	P 38	Normalisti Jg. 6 Nr. 4-5; Jg. 7 Nr. 2-6	Elbasan 1934- 1936	1		Bd. 6-7: k. E.	Zeitschriften adressiert an Dr. Norbert Jokl
727857	C	P 38	Normalisti Jg. 8 Nr. 1-4	Elbasan 1936	1		Bd. 8: k. E.	Zeitschriften adressiert an Dr. Norbert Jokl
729624	B	P 38	Leotti, Angelo: Dizionario Albanese- Italiano	Roma 1937	1	Kat.	P 38 (St.)	Widmung des Autors an Norbert Jokl
732038	B	G. Zs	Hylli i Dritës Nr. 1-11	Shkoder 1923	1		Bd. 1923/4: k. E.	Zeitschriften, adressiert an Dr. Norbert Jokl, Neustiftgasse 103.

732038	B	G. Zs	Hylli i Dritës Nr. 1-12	Shkoder 1924	1	Bd. 1924/5:	Zeitschriften, adressiert an Dr. Norbert Jokl, Neustiftgasse 103.
732038	B	G. Zs	Hylli i Dritës Nr. 1-12	Shkoder 1930	1	Bd. 1930/6: k. E.	Zeitschriften, adressiert an Dr. Norbert Jokl, Neustiftgasse 103.
732038	B	G. Zs	Hylli i Dritës Nr. 1-12	Shkoder 1931	1	Bd. 1931/7: k. E.	Zeitschriften, adressiert an Dr. Norbert Jokl, Neustiftgasse 103.
732038	B	G. Zs	Hylli i Dritës Nr. 1-12	Shkoder 1932	1	Bd. 1932/8: k. E.	Zeitschriften, adressiert an Dr. Norbert Jokl, Neustiftgasse 103.
732038	B	G. Zs	Hylli i Dritës Nr. 1-12	Shkoder 1933	1	Bd. 1933/9: k. E.	Zeitschriften, adressiert an Dr. Norbert Jokl, Neustiftgasse 103.
732038	B	G. Zs	Hylli i Dritës Nr. 1-12	Shkoder 1934	1	Bd. 1934/10: k. E.	Zeitschriften, adressiert an Dr. Norbert Jokl, Neustiftgasse 103.
732038	B	G. Zs	Hylli i Dritës Nr. 1-12	Shkoder 1935	1	Bd. 1935/11: k. E.	Zeitschriften, adressiert an Dr. Norbert Jokl, Neustiftgasse 103.
732038	B	G. Zs	Hylli i Dritës Nr. 1-12	Shkoder 1936	1	Bd. 1936/12: k. E.	Zeitschriften, adressiert an Dr. Norbert Jokl, Neustiftgasse 103.

732039	C	P 38	Ora. Organ kultural i përjavëshëm me piktura Nr. 1-42	Tirane 1929	1	P 38 (Bl.)	Bucheinband u. handschriftl. Einträge belegen Vorbesitz Jokl
732040	D	P 38	Tériade, E. (Hg.): Verve, the French Review of Art Nr. 5-6	Paris 1939	1	P 38 (St.)	Bucheinband u. handschriftl. Einträge belegen Vorbesitz Jokl
732050	B	P 38	Dobrescu, Al. V.: Argotul	Bucuresti 1938	1	P 38 (St.)	Widmung an Jokl
732053	B	P 38	Geagea, Christea: Elementul grec în dialectul Aromân	Cernauti 1931	1	P 38 (St.)	Widmung an Jokl
732059	B	P 38	Jordan, Jorgu: Introducere în studiul limbilor Romanice	Iași 1932	1	P 38 (St.)	Widmung an Jokl
732063	B	P 38	Procapovici, Al.: Mic tratat de lingvistică generală	Cernauti 1930	1	P 38 (St.)	Widmung an Jokl
732066	B	P 38	Rosetti, Alexandru: Curs de fonetică generală	Bucuresti 1930	1	P 38 (St.)	Widmung an Jokl
733332	C	P 38	Capidan, Theodor: Fărșeroții	Bucuresti 1931	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
733341	C	P 38	Koliqi, Ernesto: Epica Popolare Albanese	Padova 1937	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
733343	B	P 38	Lauriotès, Enlogios Korilos: Gregorios o Argyrokastrites	Athen 1935	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)

733356	C	P 38	Ronart, Stephan: Albanien von heute	Wien 1933	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
733359	C	P 38	Jensen, Kristian Sandfeld u. Olsen, Hedvig: Syntaxe Roumaine Bd. 1	Paris 1936	1	Bd. 1: P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
733360	C	P 38	Tagliavini, Carlo: L'Albanese di Dalmazia	Firenze 1937	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
733361	C	P 38	Tirana 1604-1937	Tirane 1937	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
734007	C	P 38	Baldacci, Antonio: Studi speciali Albanesi Bd. 2	Roma 1933	1	Bd. 2: P 38 (St.)	Rezensionsexemplar f. Jokl
734254	B	P 38	Cordignano, Fulvio: Nji theter filozofi a fé izlame?	Shkoder 1932	1	P 38 (St.)	Widmung an Prof. Dr. Jokl
734263	B	P 38	Mjedja, Ndré: Vrejthe mbi artikuj e pëmna pronës të giûhës shqipe	Shkodrë 1934	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
734265	C	P 38	Ndrenika, Leonida: I pelasgi e la loro lingua	Scutari 1936	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
734269	B	P 38	Pika, T.: Gogomelët. Polemikë me z. Kostaq Cipo	Korce 1935	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
734270	B	P 38	Pika, T.: Shenime kritike permby gjuhen	Korce 1930	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)

734273	B	P 38	Sevo, Guri Kr.: Petro Luarasi. Mësonjësi im i shqipes	Tirana 1936	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
734290	B	P 38	Buzuku, Gjon: Monumenti më i vjetri i Giuhës Shaype	Shkoder 1930	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
734294	B	P 38	Fishta, Gjergj: Lahuta e Malcis	Shkoder 1937	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
734305	B	P 38	Gashi, A.: Gjeografia e përgjithshme	Tirane 1935	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
734313	B	P 38	Haxhiademi, Etëhem: Pirrua	Tirane 1934	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
734314	B	P 38	Homer: Libri XXII i Illiadës	Shkoder 1938	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
734336	B	P 38	Programi i kremtimeve të 25 vjetorit të vet-qeverimit	o. O. 1937	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
734339	B	P 38	Rrota, Justin: Per historin e Alfabetit Shqyp	Shkoder 1936	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
734341	B	P 38	Samay, René: Aventurat e Marko Polos	Tirane 1931	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
734350	B	P 38	Spasse, Sterjo: Nga jeta ne jete.	Korce 1935	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
734351	B	P 38	Stërmilli, Haki: Burgu	Tirane 1935	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
734355	C	P 38	Terminellogji ushtarake	Tirane 1932	1	P 38 (St.)	Widmung an Jokl

734359	B	P 38	Xhuvani, Aleksander: Psikologji e shtime në punë t'edukatës (Fillime të pedagogjisë Bd. 1)	Tirane 1933	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
734359	C	P 38	Xhuvani, Aleksander: Didaktika (Fillime të pedagogjisë Bd. 2)	Tirane 1933	1	P 38 (St.)	Widmung an Prof. Jokl
734360	B	P 38	Xhuvani, Aleksander u. Cipos, K.: Fillime të Stilistikës e të Letresisë	Tirane 1930	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
734362	B	P 38	Xhuvani, Aleksander: Sintaksa Shqip	Tirane 1934	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
734363	C	P 38	Xhuvani, Aleksander: Njohnit'e para të Sintaksës Shqipe	Tirane 1935	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
734432	A	P 38	Kalendari Kombiar Jahrgang 1912	Sofija 1912	1	Jg. 1912: k. E.	Widmung an Prof. Jokl
734432	A	P 38	Kalendari Kombiar Jahrgang 1918	Sofija 1918	1	Jg. 1928: k. E.	Widmung an Norbert Jokl
734440	C	P 38	Studenti Shqiptar. Riviste mujore kulturale Nr. 1	Torino 1929	1	1929/1: P 38 (St.)	In Bd. 2-3: Briefumschlag adressiert an Dr. Jokl, höchstwahrscheinlich alle Bde VB Jokl

734440	C	P 38	Studenti Shqiptar. Riviste mujore kulture Nr. 2-3	Torino 1929	1	1929/2-3: k. E.	In Bd. 2-3: Briefumschlag adressiert an Dr. Jokl, höchstwahrscheinlich alle Bde VB Jokl
734440	C	P 38	Studenti Shqiptar. Riviste mujore kulture Nr. 4-5	Torino 1929	1	1929/4-5: k. E.	In Bd. 2-3: Briefumschlag adressiert an Dr. Jokl, höchstwahrscheinlich alle Bde VB Jokl
734584	B	P 38	Defoe, Daniel: Robinson	Tirane 1936	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
735166	B	P 38	Botim i së Përkohsmes	Shkoder 1936	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
735232	B	G: Zs	Laimet e komisis letrare shqipe në Shkodër	Shkoder 1918	1	P 38 (St.)	Widmung an Jokl
735245	D	P 38	Lirija. Gazete shqip Jg. 1908	Ctune 1908	1	Jg. 1908: P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
735248	C	P 38	Shekulli XX. Rivistë e përmuejshme letrare - shkencore Nr. 1-10	Tirane 1932/33	1	10 Hefte in einem Bd.: k. E.	handschriftliche Eintragungen, von Jokl
735665	B	P 38	Belegu, Xhafer: Lidhja e Prizrenit e veprimet e sajë	Tirane 1939	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
738217	B	P 38	Fogar, Heinrich (Hohenauer, Friedrich): Durch Raum und Zeit	Wien 1931	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)
738223	B	P 38	Hamilton, Sir George Rostrevor: Memoir 1887-1937	London 1938	1	P 38 (St.)	Jokl (Ti.)

B. Porträtsammlung

Erwerbungszi.	Signatur	Format	Art des Objektes	Erwerbungsdat.	Künstler/Fotograf	Name des Dargestellten	Stand	Proven Inventar
413	31134 Pf C (63)	qu. 8	Foto	1943		Franz Ferdinand	Habsbg.-Lothr.	Jokl
414	keine Sign.	vis.	Foto	1943		Jokl, Norbert	Bibliothekar	Jokl
415	508 Pf B (3)	vis.	Foto	1943	Scolik	Jokl, Norbert	Bibliothekar	Jokl
416	508 Pf B (4)	vis.	Foto	1943		Jokl, Norbert	Bibliothekar	Jokl
417	508 Pf B (2)	vis.	Foto	1943	Swatisch	Jokl, Norbert	Bibliothekar	Jokl
418	508 Pf B (1)	vis.	Foto	1943	Bing	Jokl, Norbert	Bibliothekar	Jokl
419	508 Pf B (6)	A.K.	Foto	1943	Fayer	Jokl, Norbert	Bibliothekar	Jokl
420	keine Sign.	qu. 8	Foto	1943		Jokl, Norbert	Bibliothekar	Jokl
421	Doubl.	gr. fo.	Foto	1943	Fayer	Jokl, Norbert	Bibliothekar	Jokl
422	keine Sign.	A.K.	Foto	1943	Kuse	Schilling, Else	Schauspielerin	Jokl

C. Handschriften-, Autographen und Nachlass-Sammlung

1. Autogr. 275/38-86; 281/34-85, 279/1-116; 358/2-4. Nachlass von Prof. Jokl (1877-1942). Prov. lt. ZWB IV, fol. 27 v ff. u. 33v: „Nachlass Dr. Norbert Jokl“ (s. auch Beilage 5)
2. Ser. n. 11.779-11.922: Nachlass von Prof. Jokl (1877-1942). Prov.: „Nachlass Jokl; nach seinem Tode (März 1942) der Bibliothek übermittelt“ (s. Beilage 5)
3. Ser. n. 9368: Franz Freiherr von Nopcsa: Tagebücher 1897-1917. Prov. Kat. Ser. n. S. 187: „Aus altem Bestand (Nachlass Jokl) 1958 aufgestellt“
4. Ser. n. 9392: Franz Freiherr von Nopcsa: Die Bergstämme Nordalbaniens und ihr Gewohnheitsrecht. Prov. Kat. Ser. n. S. 200: „Aus Nachlass Jokl stammend“
5. Ser. n. 9393: Franz Freiherr von Nopcsa: Religiöse Anschauungen, Sitten und Gebräuche der Albaner. Prov. Kat. Ser. n. S. 200: „Aus Nachlass Jokl stammend“

6. Ser. n. 9443: Bajazid Elmaz: Die Albaner des oberen Rekatales bei Dibra. Prov. Kat. Ser. n. S. 224: „1959 Aus dem Nachlass Jokls aufgestellt“

D. Druckschriften / AB 46

Signatur	Format	Provenienz/Inventar	Autor/Titel	Impressum	Anzahl Bde.	Standort	Provenienz Buch	Anmerkungen
218813	B	A.B. 1946	Martelli, Gino Luigi: Lingua etrusca	Perugia 1920	1		AB 46	Widmung an Jokl 28.5. 1920
221478	A	G. A.B. 1946	Stifter, Adalbert: Der Nachsommer Bd. 1	Pesth o. J.	1		AB 46	Norbert Jokl Cand. jur. (Ti.)
221478	A	G. A.B. 1946	Stifter, Adalbert: Der Nachsommer Bd. 2	Pesth o. J.	1		AB 46	Norbert Jokl Cand. jur. (Ti.)
221478	A	G. A.B. 1946	Stifter, Adalbert: Der Nachsommer Bd. 3	Pesth o. J.	1		AB 46	Norbert Jokl Cand. jur. (Ti.)
224719	A	A.B. 1946	Grisebach, Eduard (Hg.): Schopenhauers Briefe an Becker, Frauenstädt, von Doß, Lindner und Asher	Leipzig o. J.	1		AB 46	Norbert Jokl stud. jur. 1896 (Ti., teilweise unkenntlich gemacht)
227011	B	A.B. 1946	Schack, Adolf Friedrich Graf von: Stimmen vom Ganges	Stuttgart 1877	1		AB 46	Dr. Norbert Jokl
229292	B	A.B. 1946	Fodor, Nicolaus: Theoretisch- praktischer Lehrgang der ungarischen Sprache	Budapest 1894	1		AB 46	Handschriftliche Anmerkung von N. Jokl

247573	A	AB 46	Rylejev, Kondratij Feodorovic: Vojnarovskij i zaprescennyja stichotvorenija	Leipzig 1880	1		AB 46	Dr. Norbert Jokl
295789	B	A.B. 1946	Jokl, Norbert: Balkanlateinische Untersuchungen	Beograd 1936	1		AB 46	handschriftliche Anmerkungen von N. Jokl
791965	B	AB 46	Überweg, Friedrich: Grundriss der Geschichte der Philosophie	Berlin 1886-1888	1		Bd. 1: AB 46	Norbert Jokl cand. iur.
791965	B	AB 46	Überweg, Friedrich: Grundriss der Geschichte der Philosophie	Berlin 1886-1888	1		Bd. 2: AB 46	Norbert Jokl cand. iur.
791965	B	AB 46	Überweg, Friedrich: Grundriss der Geschichte der Philosophie	Berlin 1886-1888	1		Bd. 3: AB 46	Norbert Jokl cand. iur.
826752	B	AB	Schack, Adolph Friedrich Graf von: Spanisches Theater in 2 Bänden"	Stuttgart 1845	1	Theat.S.		Norbert Jokl stud.jur. (Ti.)
826752	B	AB	Schack, Adolph Friedrich Graf von: Spanisches Theater in 2 Bänden"	Stuttgart 1845	1	Theat.S.		Norbert Jokl stud.jur. (Ti.)